

DOKUMENT I POLITIKAVE VENDORE PËR FËMIJËRINË E HERSHME

**“ÇDO FËMIJE ROM NË CIKLIN
PARASHKOLLOR”**

BASHKIA ROSKOVEC

DOKUMENT I POLITIKAVE VENDORE PËR FËMIJËRINË E HERSHME

“ÇDO FËMIJE ROM NË CIKLIN
PARASHKOLLOR”

BASHKIA ROSKOVEC

Ky dokument u përgatit nga ekspertet e ISDC në bashkëpunim me stafin e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve.

Iniciativa për studimin dhe publikimin e këtij dokumenti zhvillohet në zbatim të projektit “ Cdo fëmijë Rom në kopsht”, realizuar në bashkëpunim me UNICEF në Shqipëri gjatë periudhës Maj- Dhjetor 2016

Përmbajtja e këtij Dokumenti është përgjegjësi e Observatorit dhe nuk shpreh domosdoshmërisht opinionin e UNICEF.

©Observatori/Unicef

PËRMBAJTJA

HYRJE DHE PERSHKRIME TË PËRGJITHSHME	5
METODOLOGJIA	7

1. PJESA E PARË

1.1. DOKUMENTA STRATEGJIKE DHE RAPORTIME PËR ROMËT DHE EGJIPTIANËT (REKOMANDIME TË BE-së, KE-së APO DHE OSBE-së)	8
1.2. BAZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE - RASTI I SHQIPËRISË	9
1.3. TË DHËNA STATISTIKORE	11
1.4. STRATEGJITË RAJONALE PËR ROMËT DHE EGJIPTIANËT DHE GJENDJA E TYRE NË SHQIPËRI	12

2. PJESA E DYTË

2.1. PLANI I VEPRIMIT 2016-2020	14
2.2. PUNËSIMI/PAPUNËSIA E KOMUNITETEVE ROME DHE EGJIPTIAN	15
2.3. TË DHËNA PËR STRATEGJINË KOMBËTARE PËR ROMËT DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE	16
2.4. FINANCIME APO BUXHETIME NË NIVEL KOMBËTAR	18
2.5. ROLI I QEVERISJES VENDORE	18

3. PJESA E TRETË

3.1. STRATEGJITË/PLANET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT NË NIVEL VENDOR	23
3.2. FËMIJËT ROM DHE EGJIPTIAN NË KËTO STRATEGJI - RASTI I ROSKOVECS	26

4. PJESA E KATËRT

4.1. ANALIZA E SITUATËS	28
4.2. PROBLEMATIKAT DHE NEVOJAT	29
4.3. MUNDËSITË PËR NDËRHRYJE	31
4.4. REKOMANDIME	31

ANEKS

BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE	35
--	----

HYRJE DHE PËRSHKRIME TË PËRGJITHSHME

Ky dokument përqëndrohet në temën e krijimit të mundësive nga ana e njësive të qeverisjes vendore për integrimin e komuniteteve romë dhe egjiptiane, për pjesëmarrjen e tyre në vendimarrjet vendore që prekin drejtpërdrejtë jetën e nevojat e tyre dhe sidomos në krijimin e rrethanave dhe mundësive që fëmijët e këtyre komuniteteve të frekuentojnë ciklin parashkollor.

Ai paraqet një përmbledhje të strategjive rajonale, kombëtare dhe vendore, të bazës ligjore dhe institucionale, të praktikave më të mira dhe të perpjekjeve të shoqërisë civile mbështetur nga donatorë të ndryshëm, por kryesisht nga UNICEF, për të krijuar mundësitë e zhvillimeve progresive në nivel vendor dhe të qendrueshëm në arritje të rezultateve në zbatim të rekomandimeve dhe projekteve konkrete për rritjen e shpresës dhe mundësive integruese për familjet romë dhe egjiptiane në njësinë vendore Roskovec. Ky dokument, prezanton prioritetet dhe projekte konkrete në mbështetje edhe të praktikave të mira të iniciuara nga vetëqeverisja vendore, institucionet e pavarura, shoqëria civile dhe aktorë të tjerë që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi kushtet e jetesës dhe integrimin e romëve dhe egjiptianëve.

Qëllimi i këtij dokumenti është i shumëfishtë. Së pari, ai synon të ndihmojë të zgjedhurit vendor të kuptojnë realitetin e këtyre komuniteteve në njësinë e tyre vendore, paralelisht me njohjen e tyre me dokumentet strategjike kombëtare dhe rajonale, si dhe nevojën për hartimin e planeve lokale të veprimit. Njëkohohësisht, ky dokument prezanton analizën dhe nevojën e programeve dhe aktiviteteve në periudha afatshkurtra dhe afatmesme, të cilat rrjedhimisht mund të shërbejnë për ushqimin e programeve sociale në kuadër të Strategjisë së Zhvillimit të Territorit të bashkisë. Përmes këtij dokumenti dhe rekomandimeve përkatëse synohet të orientohen buxhetet afatmesme dhe vjetore për të projektuar shpenzimet e nevojshme në zbatimin e aktiviteteve për arritjen e rezultateve të kërkuara.

Dokumenti është prodhuar në kuadër të projektit "Çdo fëmijë Rom në parashkollor" e mbështetur nga UNICEF dhe zbatuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, CRCA, YWCA, e cila synon ndërtimin e rrjeteve të advokimit dhe praktikave të suksesshme në integrimin e fëmijëve rom. Ajo ka për qëllim ngritjen dhe mbështetjen e rrjeteve lokale për advokim bazuar në zhvillimin e hershëm të fëmijëve rom. Kjo nismë realizohet në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet



sociale (punonjës socialë) dhe institucionet e tjera që ofrojnë kujdes dhe mbrojtje për fëmijët, OJF-të dhe partnerë të tjerë socialë. Projekti ilustron se si aktorë kombëtarë dhe lokalë, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, përfaqësues të komuniteteve romë dhe egjiptiane në bashkëpunim me njësitë

vendore, të cilat bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e veta të ngarkuara me ligj pas Reformës së Territorit, mund të rrisin ndërgjegjësimin në lidhje me politikat dhe praktikën e mira që promovojnë ndjekjen nga fëmijët e komuniteteve romë dhe egjiptiane të ciklit parashkollor.

Është e ditur se në këto tema qeveria ka pasur deri diku arritje në zhvillimin dhe miratimin e strategjive kombëtare për përmirësimin e situatës së romëve dhe egjiptianëve, por shfaqë megjithatë mangësi të konsiderueshme në zbatimin efektiv të tyre, veçanërisht në nivel lokal. Çështjet e diskriminimit dhe nivelit të ulët të pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në vendimmarrje prekin drejtpërdrejt integrimin e tyre në të gjitha sferat e jetës. Mungesa e përfaqësimit në struktura vendimarrëse vendore, mungesa e aftësive organizative, nevoja ekonomike deri në mbijetesë janë tregues i asaj që në fakt është sfida e së ardhmes në vendin tonë, por që instrument në rritje të përfshirjes së tyre në të ardhmen duhet të jetë qeverisja vendore.

Duke pasur parasysh pozitën e pasigurtë të minoritetëve romë dhe egjiptianë në Ballkanin Perëndimor dhe vëmendjen gjithnjë e më të madhe ndërkombëtare për rëndësinë e integritetit social të këtij komuniteti, analiza e bërë në këtë dokument vjen në kohën e duhur. Ai ofron një analizë nevojash dhe mundësish të asaj që është bërë, që duhet bërë dhe pse. Një zgjidhje e qëndrueshme për romët dhe egjiptianët ka nevojë për bashkëpunim të plotë të organeve qeveritare, autoriteteve lokale, aktorëve të tjerë të përfshirë dhe natyrisht vetë romëve dhe egjiptianëve.

METODOLOGJIA

Dy metodat kryesore të grumbullimit të të dhënave në përgatitjen e dokumentit ishin shqyrtimi i dokumenteve strategjike, i raporteve të analizave ekzistuese, i bazës ligjore dhe institucionale, si dhe (kryesisht faza e dytë) takimet me komunitetet në terren dhe marrja e mendimeve të tyre për analizën e nevojave dhe hapave që duhen hedhur në të ardhmen, me qëllim rritjen e qendrueshmërisë së trajtimit të problemeve, përfshirjen e tyre në vendimmarrje dhe ndërgjegjësimin e strukturave vendore në rritjen e rolit të tyre në këtë drejtim.

Ky shqyrtim dokumentesh mbulon ligjet, dokumentet e politikave dhe raportet nga politikat dhe nismat e centralizuara, duke përfshirë veç të tjerash, antidiskriminimin dhe ligjet përkatëse, strategjitë kombëtare për romët dhe planet kombëtare të veprimit në kuadër të Dekadës së Romëve. Janë shqyrtuar gjithashtu planet lokale të veprimit për romët (aty ku ekzistojnë) dhe dokumentet e tjerë të hartuar në nivel lokal.

Qëllimi kryesor i kësaj faze është të drejtohet tej hulumtimit, duke përcaktuar dokumentet përkatëse dhe palët e interesuara për t'u intervistuar e takuar në terren, por edhe duke i dhënë një material orientues njësisë vendore në kuadër të planeve të përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe strategjive për zhvillim ekonomik lokal dhe integrim.

Faza e analizave paraprake ka formuar bazën për takimet informuese me komunitetet romë dhe egjiptiane, si dhe me zyrtarët e agjensive kombëtare, të dekoncentruara dhe ato vendore, çka mundësoi verifikimin e fakteve dhe identifikimin e nevojave, aktorëve lokalë dhe jo vetëm, në gjendje dhe të gatshëm për të siguruar mbështetje të nevojshme dhe të arsyeshme për arritjen e qëllimeve të projektit.

Faza e dytë ishte faza e hulumtimit të punës me komunitetet, e cila u zhvillua në terren me intervistat e aktorëve brenda dhe jashtë projektit. Synimi i intervistave me aktorët e tjerë ishte të grumbulloheshin pikëpamje lidhur me praktikën në fushën e antidiskriminimit dhe pjesëmarrjes së romëve në vendimmarrje.

1. PJESA E PARË

1.1. DOKUMENTA STRATEGJIKE DHE RAPORTIME PËR ROMËT DHE EGJIPTIANËT (REKOMANDIME TË BE-së, KE-së APO DHE OSBE-së)

Parimet themelore të antidiskriminimit janë të inkuadruara në kushtetutat e Ballkanit Perëndimor, si dhe në legjislacionin dhe dokumentet strategjike për minoritetet, barazinë gjinore dhe romët. Ndërsa ngjashmëritë tejkalojnë dallimet ndërmjet iniciativave të qeverisë qendrore për antidiskriminimin, nismat e ngritura në nivel lokal shfaqin një shkallë më të madhe shumëllojshmërie.

Vlerësime për pjesëmarrjen në vendimarrje: Kujdesi për çështjet e pjesëmarrjes të drejtëpërdrejtë në vendimarrje është i pranishëm në kushtetutat dhe në legjislacionin zgjedhor të minoriteteve etnike, kulturore dhe të barazisë gjinore në Ballkanin Perëndimor, si dhe në strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit për romët. Siç është rasti me antidiskriminimin, nismat e krijuara në nivelin qendror për të nxitur pjesëmarrjen në vendimarrje ndryshojnë më pak se nismat e ngritura në nivel lokal për këtë qëllim. Nga ana tjetër, në nivel lokal duket se ka praktika më të mira dhe më të larmishme në fushën e pjesëmarrjes në vendimarrje sesa në fushën e antidiskriminimit.

Tabela e mëposhtme jep një panorama statistikore në lidhje me arsimin dhe punësimin e komuniteteve rome dhe jo rome në vendet e Ballkanit.

Tabelë: Studim mbi gjendjen e arsimit dhe strehimit në vendet e Ballkanit Perëndimor (2011)

TABELA 1. ARSIMI						
Shteti	Shkrim/leximi (mosha 16+)		Regjistrimi në shkollë (mosha 7-15)		Regjistrimi në shkollë (mosha 16-19)	
	Romë	Jo-romë	Romë	Jo-romë	Romë	Jo-romë
Shqipëria	65%	95%	48%	91%	13%	60%
Bosnje- Hercegovina	82%	97%	61%	96%	15%	72%
Kroacia	84%	99%	87%	93%	31%	77%
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	83%	96%	74%	90%	27%	65%
Mali i Zi	73%	99%	55%	94%	13%	61%
Serbia	85%	98%	80%	95%	25%	71%

TABELA 2. PAPUNËSIA DHE VARFËRIA						
Shteti	Papunësia (mosha 15-64)		Papunësia (mosha 15-24)		Varfëria bazuar në të ardhura ¹	
	Romë	Jo-romë	Romë	Jo-romë	Romë	Jo-romë
Shqipëria	23%	18%	37%	39%	37%	15%
Bosnje- Hercegovina	54%	30%	69%	56%	42%	14%
Kroacia	65%	23%	76%	34%	9%	5%
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	53%	27%	71%	61%	41%	14%
Mali i Zi	44%	30%	56%	49%	29%	5%
Serbia	49%	27%	65%	50%	30%	8%

Burimi: Raport i BE/OSBE-ODIHR/2013

Nga tabela e mësipërme shikohet që diferenca e treguesve mes popullsise rome dhe jo rome sa i përket arsimit dhe punësimit në Shqipëri është më e theksuar se në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë apo të Ballkanit Perëndimor (West Balkan Countries).

Duke njohur potencialin e planeve lokale të veprimit për të sjellë përfitime konkrete për romët dhe egjiptianët, BPRI (Best Practice Roma Integration) ka përkrahur hartimin e planeve lokale të veprimit në Mal të Zi dhe do të shfrytëzojë përvojat e projektit të atjeshëm për të ndërmarrë veprime të ngjashme edhe në Shqipëri.

Nga ky raport vihet re që punësimi i romëve në administratat lokale si pika fokale për çështjet që prekin popullatën lokale rome është i kombinuar me zhvillimin dhe miratimin e planeve lokale të veprimit për romët. Komunitetet e përzgjedhura në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbisë, ofrojnë shembull pozitiv për angazhimin afatgjatë të romëve si pika fokale. Pikat fokale lokale shërbejnë më shumë për të lehtësuar aksesin në shërbimet kryesore në vend, se sa për ta zëvendësuar atë. Një gjë e tillë mund të kihet parasysh si praktikë që mund dhe duhet të ndiqet në raste të ngjashme edhe në Shqipëri. Një shembull i këtillë pozitiv i angazhimit të pikave fokale është vërejtur edhe në Kosovë.

1.2. BAZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE - RASTI I SHQIPËRISË

Raportet e komunitetit rom si qytetarë të Republikës me qytetarët e tjerë të saj, si dhe në raport me të drejtat themelore dhe jo vetëm, mbrohen dhe mbështeten nga Kushtetuta dhe akte të tjera ligjore, nënligjore dhe jo vetëm. Kushtetuta e Shqipërisë e ndalon diskriminimin e padrejtë në baza të ndryshme, duke përfshirë edhe përkatësinë etnike. Por, ndërsa Kushtetuta garanton të drejtat kulturore të pjesëtarëve të minoriteteve, romët nuk kanë të drejtë me ligj për këtë mbrojtje, sepse ata nuk njihen si minoritet kombëtar në Shqipëri, por si një minoritet gjuhësor. Në mënyrë të ngjashme përjashtohen edhe egjiptianët nga kjo dispozitë për shkak të mungesës së njohjes zyrtare si një grup i veçantë.

Në kuadër të Dekadës së Romëve në Shqipëri është hartuar *Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Romëve të Shqipërisë 2010-2015, si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020*. Në planin e parë (2010-2015) çështjet e diskriminimit trajtohen në dy nga gjashtë fushat prioritare: **Arsim dhe Përfshirje Sociale** dhe **Mundësitë e Barabarta**.

Në arsim janë parashikuar shtatë aktivitete për realizimin e objektivit “eliminimi i qëndrimeve përjashtuese dhe inferiore ndaj romëve në komunitetin shkollor dhe transformimi i diversitetit kulturor në një burim njohurish dhe ambienti të respektit reciprok, tolerancës dhe mirëkuptimit ndaj tyre”. Në fushën prioritare të përfshirjes sociale dhe mundësive të barabarta, në anën tjetër, Objektivi 1 dhe tre aktivitete të tij të parashikuara kanë si synim parandalimin e trafikimit të fëmijëve romë dhe veçanërisht vajzave rome, ndërsa katër aktivitete të planifikuara nën Objektivin 2 janë të dizajnuara për të “fuqizuar komunitetin rom për të mbrojtur liritë dhe të drejtat, në mënyrë që të parandalohen dhe ulen rastet e diskriminimit.”

Pas marrjes së statusit të vendit kandidat në BE në vitin 2014, qeveria shqiptare intensifikoi reformat e nevojshme për aderimin e saj, përfshirë edhe nxitjen e aksesit të barabartë në shërbime dhe të të drejtave të barabarta për të gjithë shtetasit. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë i kushtohet masave që mund të shëmbin barrierat me të cilat përballen romët dhe egjiptianët sa i përket aksesit në shërbime, përmirësimit të kushteve të tyre të jetesës nëpërmjet integritetit dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor.

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve është një dokument i hartuar nga qeveria shqiptare dhe nën koordinimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ky Plan është një angazhim i ri me kohështirje 2016-2020, i cili targeton dy komunitetet përkatëse, paraqet një përshkallëzim të masave të zbatuara dhe në zbatim dhe parashikon gjithashtu nisjen e aktiviteteve të reja për nxitjen e integritit të romëve dhe egjiptianëve me fondet e parashikuara nga buxheti i shtetit, por duke identifikuar edhe hendekun financiar për periudhën 2016-2020 dhe mundësinë e financimit nëpërmjet koordinimit me ndihmën e huaj. Plani i Veprimit është hartuar në konsultim të ngushtë me ministritë përgjegjëse të linjës, përfaqësues nga komuniteti rom dhe egjiptian si dhe aktorë të tjerë¹.

Qeveria shqiptare në kuadër të këtij plani veprimi dhe të dokumentave të praktikave më të mira cituar më sipër në rrafshin e vendeve të Ballkanit Perëndimor ka ndërmarrë një sërë masash dhe ka miratuar një sërë dokumentesh, siç janë: Plani Kombëtar i Integritit European 2015-2020, Udhërrëfyesi për plotësimin e 5 prioriteteve, që përcaktojnë masa konkrete për realizimin e këtij procesi. Kjo nismë vjen edhe si një standard që duhet arritur edhe në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE.

Pesë prioritetet kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së përfshijnë, “masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikën antidiskriminuese”². Përbushja e Prioritetit 5 në Udhërrëfyesin e Qeverisë, orienton marrjen e masave në shumë fusha të politikave specifike për romët/egjiptianët si: regjistrimi civil, aksesimi në drejtësi, **arsimi**, dialogu ndërkulturor, **punësimi** dhe përmirësimi i aftësive, kujdesi shëndetsor, strehimi dhe integrimi urban dhe mbrojtja sociale.

Janë pikërisht këto fusha që kanë orientuar objektivat kryesore të përcaktuara në këtë dokument të cilat duhet të orientojnë të gjithë politikën në nivel lokal me qëndër zbutjen e problematikave dhe ofrimin e mundësive të barabarta, si dhe mbështetjen e vazhdueshme edhe të planifikuara për komunitetet romë dhe egjiptiane. Gjithashtu, duke marrë parasysh angazhimet e përshkruara në dokumentin Udhërrëfyes, Plani i Veprimit jep një listë më të detajuar të aktiviteteve që do të zbatohen gjatë periudhës 2016-2020.

Institucionet vendore të parashikuara për zbatimin e aktiviteteve në këtë Plan Veprimi janë bashkitë, të cilat pas Reformës Administrative Territoriale kanë një peshë specifike më të madhe. Në Strategjinë e Decentralizimit, e cila në vetvete është një plan veprimi për periudhën 2015-2020 për të orientuar të gjithë platformën decentralizuese me qëllim konsolidimin e autonomisë vendore, mes të tjerash merr parasysh rritjen e autoritetit të tyre edhe në fushën e shërbimeve sociale. Bashkitë organizohen dhe funksionojnë sipas Ligjit të ri organik No.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Ligji organik “Për Vetëqeverisjen Vendore” ka marrë parasysh rolin e njësive vendore në ofrimin e shërbimeve sociale në përgjithësi, si dhe ato të cilat i përkasin vlerave të ndryshme të bashkësisë për të cilën votohet dhe është i mandatuara për t’i ofruar shërbime. Natyrisht, kjo mbështetur në Kushtetutë, e cila ka në themel të saj respektimin e parimeve themelore të barazisë dhe të proporcionalitetit.

Në nenin 3 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” thuhet që misioni i vetëqeverisjes vendore siguron qeverisjen sa më afër qytetareve duke njohur ekzistencën e vlerave të ndryshme të

¹ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020

² Bashkimi Evropian, *Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014*, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf, f. 19.

bashkësisë, të respektimit të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuar në Kushtetutë ose ligje të tjera.³

Sa më sipër, del qartë që në ofrimin e shërbimeve për komunitetet rome dhe egjiptiane bashkitë janë në misionin e tyre dhe të detyruara me ligj. Po kështu, më poshtë në këtë nen thuhet se bashkia duhet të ofrojë shërbime (edhe ato sociale) në forma të përshtatshme bazuar në nevojat e bashkësisë nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së tyre në qeverisje, si dhe bazuar në standardet e kërkuara nga ligji apo aktet normative. Pra, bashkia duhet të zbatojë aktet normative të ministrisë së linjës, pra asaj të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe Ministrisë së Arsimit sa i përket standardeve të vendosura për këtë qëllim, ku ndër të tjera citohen në udhëzimet e kësaj ministrie edhe kudesi i veçantë për komunitetet rome dhe egjiptiane⁴⁵⁶.

1.3. TË DHËNA STATISTIKORE

Historikisht popullsia shqiptare është karakterizuar nga marrëdhënie harmonike midis pakicave etnike dhe shumicës. Këto marrëdhënie kanë evoluar në shekuj duke e dalluar Shqipërinë si vend model për bashkëjetesën midis komuniteteve etnike dhe besimeve fetare.

Minoriteti rom konsiderohet një minoritet gjuhësor. Të dhënat statistikore lidhur me numrin e romëve që jetojnë në Shqipëri mungojnë, pasi një regjistrim i përgjithshëm i tyre nuk është bërë asnjëherë. Për herë të parë romët u regjistruan në Shqipëri gjatë viteve 1522-23 dhe u vlerësuan rreth 1,270 vetë. Emri i romëve përmendet në tekstet e vjetra shqiptare me 1635. Në vitin 1930 sipas vlerësimeve popullore kishte 20,000 romë në tërë vëndin. Në 1980 kishte 62,000 romë, të vlerësuar sipas dokumentave franceze. Kjo shifër u bazua në burime angleze. Më 1995 Grupi Ndërkombëtar i të Drejtave të Minoriteteve vlerësoi se numëri i romëve ishte midis 90,000 dhe 100,000 vetë. Ndërsa Universiteti i Marylandit në 1995 deklaroi se ka deri në 120,000 romë që jetojnë në Shqipëri. Sot vlerësohet që ritmi i shtimit të popullsisë rome është 3% i cili paraqitet më i lartë se ai i shqiptarve. Pasaktësia e shifrave vjen nga fakti se asnjë regjistrim zyrtar në Shqipëri nuk i ka evidentuar romët.

Shifrat për komunitetet rome dhe egjiptiane të ofruara nga organizma të ndryshëm japin panoramë të ndryshme. Sot në Shqipëri njihet minoriteti etno-linguistik rom dhe nga ana tjetër komuniteti egjiptian. Nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në vitin 2011 u identifikuan vetëm 8.300 romë dhe 3.368 egjiptianë. Të dhëna të tjera nga studime të ndryshme raportojnë për 18.276⁷ deri në 120.000 romë⁸ dhe supozohet për më shumë se 200.000 egjiptianë⁹, gjë që e bën përfshirjen e tyre social-ekonomike me rëndësi për zhvillimin e përgjithshëm të vendit¹⁰.

³ Ligji Nr. 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”

⁴ Udhëzim Nr.25/2015 i përbashkët i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

⁵ Udhëzim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për vitin 2016-2017.

⁶ Urdhër i Përbashkët Nr. 2; i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Brendshme dhe të Shëndetësisë “Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të datës 02.08.2013, “Për identifikimin dhe detyrimin e regjistrimit në shkollë të të gjithë femijëve të moshës së detyrimit shkollor”.

⁷ Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), *Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri*, prill 2014, http://www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf. Ky numër është vetëm për romët që jetojnë në zona të përqëndruara.

⁸ Përllogaritje të siguruar nga shoqata rome “Amarodrom”, të cituara në raportin e Bankës Botërore *Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: Nga përjashtimi social në përfshirjen sociale*, i përgatitur nga Hermine De Soto, Sabine

Shqetësim të madh për institucionet qendrore dhe vendore paraqet sidomos situata e fëmijëve në raport me frekuentimin e shkollave. Fëmijët romë dhe egjiptianë kanë përqindje të ulëta të regjistrimit në shkollë, analfabetizmit dhe përfundimit të shkollës krahasuar me mesataren kombëtare. Rreth 40,3% e romëve dhe 12,7% e egjiptianëve janë analfabetë, ndërsa mesatarja kombëtare është vetëm 1,6%. Sipas UNICEF, 33,9% e popullsisë rome është nën 14 vjeç dhe për rrjedhojë duhet të ndjekë shkollën¹¹. Gjithsesi, shumë fëmijë nuk janë regjistruar kurrë dhe përqindja e braktisjes së shkollës është e lartë. Nëse kësaj analize i shtohet fakti që programet e ciklit fillor janë bazuar në një formim paraprak që fëmijët duhet të marrin në ciklin parashkollor, atëherë vetëkuptohet edhe një arsye shtesë e braktisjes së shkollave apo e mos regjistrimit të fëmijëve romë dhe egjiptian, pasi ato ndjehen edhe nqs shkojnë në shkollë shumë më vonë se duhet të kenë kaluar ciklin parashkollor.

Një numër i madh nxënësish romë braktisin arsimin e detyruar jo vetëm si rezultat i qëndrimeve diskriminuese, mungesës së mbështetjes dhe ngacmimeve në shkollë, por edhe për shkak të nevojës për të ndihmuar prindërit e tyre në aktivitete që gjenerojnë të ardhura¹². Sipas studimit të kryer nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), bashkitë më të prekura nga braktisja e arsimit të detyrueshëm janë Tirana, Korça, Elbasani, Fieri, Durrësi dhe Berat¹³.

1.4. STRATEGJITË RAJONALE PËR ROMËT DHE EGJIPTIANËT DHE GJENDJA E TYRE NË SHQIPËRI

Në lidhje me temën që po trajtohet, bazuar në direktiva të ndryshme të UNICEF, BE dhe te organizmave të ndryshëm ndërkombëtar, dekada 2010-2020 është quajtur Dekada Rome. Mbështetur në këto direktiva ndërkombëtare, si dhe në raporte e studime të shumta të bëra në rajon dhe në vendin tonë janë hartuar dy plane kombëtare veprimi për integrimin e romeve dhe egjiptianëve, ai i viteve 2010-2015 dhe 2016-2020. Planet që është aktualisht në fuqi, ai 2016-2020 mbështet punën e vetë në disa parime themelore.

Parimet që udhëheqin *Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve*¹⁴ janë:

Beddies dhe Ilir Gedeshi, 2005,

<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/7313/32181.pdf?sequence=1>, f. xxiv.

⁹ *Po aty*, përlogaritje e siguruar nga shoqata egjiptiane “Vëllazërimi”.

¹⁰ Romët në Shqipëri njihen si minoritet gjuhësor, që është një status i nivelit të dytë krahasuar me minoritetet kombëtare (grekët, malazezët dhe maqedonasit). Ndryshe nga romët, egjiptianëve nuk u është dhënë status minoriteti me arsyetimin se ata nuk e kanë ruajtur identitetin e tyre (si p.sh. gjuhën) dhe e identifikojnë veten si shqiptarë. Romët dhe egjiptianët janë dy komunitete të marginalizuara dhe që vuajnë përjashtimin social. Në Rishikimin Periodik Universal të vitit 2014, Shqipëria raportoi se “një grup pune ndër-institucional po punon për rishikimin e kuadrit ekzistues legjislativ dhe institucional dhe për trajtimin e ankesave nga minoritetet. Grupi i punës ka përgatitur një analizë të plotë të legjislacionit dhe politikave të qeverisë që afektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë pakicat që jetojnë në Shqipëri. Gjithashtu analiza përmban edhe rekomandime për ndërhyrje në legjislacionin aktual”.

¹¹ UNICEF dhe Qendra e Studimeve Ekonomike dhe Shoqërore, *Hartëzimi i fëmijëve romë në Shqipëri*, 2011, http://www.sidalbania.org/Mapping_roma_children_english_may_5_2012.doc, f. 5.

¹² Sipas studimit të OSFA-së, 4% e fëmijëve të moshës 6-17 vjeç janë të angazhuar në punë të ndryshme.

¹³ OSFA, *Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri*, prill 2014, www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf

¹⁴ Këto parime u frymëzuan nga *Parimet e përbashkëta bazë për përfshirjen e romëve të BE-së në 2009*, që gjenden në

http://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Documents/2011_10_Common_Basic_Principles_Roma_Inclusion.pdf.

1. *Nxitja e përfshirjes sociale* – Aktivitetet e Planit të Veprimit synojnë të nxisin përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në shoqëri e jo të krijojnë sisteme paralele për t'u përdorur nga këto komunitete.
2. *Përdorimi i një qasjeje të targetuar/ synuar për trajtimin e çështjeve specifike të përjashtimit* – Plani i Veprimit propozon gjithashtu masa të targetuara për përgjigjen ndaj situatave të emergjencës që nuk mund të trajtohen përmes burimeve të përgjithshme. Ndërhyrjet e targetuara nuk do të krijojnë diskriminim (p.sh., përmes strehimit apo klasave të ndara për romët dhe egjiptianët), por synojnë të lidhin romët dhe egjiptianët me sistemin e përgjithshëm dhe të përmirësojnë aksesin e tyre në shërbimet publike ekzistuese.
3. *Respektimi i dallimeve* – Plani i Veprimit respekton dallimet mes komunitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe brenda vetë këtyre komuniteteve. Plani i Veprimit trajton anëtarët vulnerabël të këtyre komuniteteve, duke njohur faktin që disa romë dhe egjiptianë janë tashmë të integruar në shoqëri.
4. *Vënia e theksit mbi angazhimin e romëve dhe egjiptianëve* – Plani i Veprimit përfshin mekanizmat për angazhimin e romëve dhe egjiptianëve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike.
5. *Nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm* – Krijimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit bazohet në bashkëpunimin midis qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, shoqërisë civile, komunitetit ndërkombëtar dhe veçanërisht vet komuniteteve.
6. *Promovimi i lidhjeve ndër sektoriale* – Plani i Veprimit trajton nevojat në një sërë fushash kyçe përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimin urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, regjistrimin civil dhe akses në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritetit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.
7. *Matja e progresit* – Plani i Veprimit është i pajisur me tregues për matjen e progresit të zbatimit dhe treguesit fillestarë (nga ku do të nisë puna) kur është e mundur.
8. *Ndërgjegjësimi mbi dimensionin gjinor* – Plani i Veprimit pranon faktin se gratë romë dhe egjiptiane kanë më tepër gjasa të vuajnë përjashtimin dhe diskriminimin gjinor. Dokumenti bën gjithashtu thirrje për mbledhjen e të dhënave të disagreguara sipas gjinisë për çdo tregues përkatës.
9. *Buxhetimi për zbatimin* – ministritë e linjës kanë identifikuar një buxhet për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi publik është i pamjaftueshëm, ministritë kanë identifikuar edhe hendeqet e financimit ku mund të kërkohet ndihmë nga donatorë.

Bazuar në këto parime, Plani i Veprimit 2016-2020 është hartuar me një metodologji ku kryesorja ka qenë pjesëmarrja e gjerë e institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe grupet e interesit së bashku me shoqërinë civile.

Plani i Veprimit 2016-2020 është një dokument voluminoz prej 140 faqesh dhe jep një analizë të hollësishme, si dhe një panoramë makro në nivel kombëtar për situatën dhe masat që do të merren në implementimin e parimeve të tij, me qëllim që të kapen objektivat e këtij plani veprimi sa i përket arsimin dhe punësimin.

2. PJESA E DYTË

2.1. PLANI I VEPRIMIT 2016-2020

Matrica e Planit të Veprimit¹⁵ përshkruan qëllimet, objektivat dhe aktivitetet, afatet e zbatimit, autoritetet përgjegjëse për zbatim dhe kontroll, vlerat e treguesve dhe pikës së nisjes, burimet e informimit, dokumentat strategjik përkatës, si dhe fondet e nevojshme për zbatimin e Planit të Veprimit. Matrica është e ndarë në gjashtë sektorë prioritarë, specifikisht:

1. Regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi
2. **Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor**
3. **Punësimi dhe arsimi e formimi profesional (AFP)**
4. Kujdesi shëndetësor
5. Strehimi dhe integrimi urban
6. Mbrojtja sociale

Masat e Planit të Veprimit në këto fusha janë të bazuara në nevojat e romëve dhe egjiptianëve të identifikuar nëpërmjet të dhënave bazë dhe anketimeve, por gjithashtu ato janë bazuar edhe në mundësitë e burimeve dhe kapacitetet e qeverisë për t'iu përgjigjur këtyre masave.

Plani i veprimit duhet të shërbejë si udhërrëfyes për njësitë vendore që në kuadër të ndërtimit të politikave të tyre lokale të mbështeten në prioritetet, objektivat dhe qëllimet e këtij plani, në mënyrë që të rrisin aksesin e tyre në fondet konkurruese të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve ose në fonde të tjera të Qeverisë Qendore.

Plani i Veprimit 2016-2020 është hartuar pas një konsultimi të gjerë me ministrinë e linjës, nën drejtimin e posaçëm të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me përfaqësues nga shoqëria civile rome dhe egjiptiane. Këto bënë të mundur identifikimin e nevojave dhe hartimin e synimeve, objektivave dhe aktiviteteve në secilin sektor.

Pushteti vendor. Përfaqësues nga këshillat e qarqeve dhe bashkitë kryesore kanë dhënë imputet e tyre në hartimin e këtij Plani. Për pasojë aty përfshihen edhe këndvështrimet e njësive vendore të cilat kanë dhe do kenë një rol domethënës në zbatimin e tij për të arritur objektivat e vendosura.



¹⁵ Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020

Shoqëria civile duke përfshirë organizatat rome dhe egjiptiane kanë marrë pjesë në procesin e hartimit të Planit. Përfaqësues të organizatave rome dhe egjiptiane, përfaqësuesi rom i Komitetit Shtetëror për Minoritetet, ekspertë rom dhe egjiptian që punojnë në institucione të pavarura kanë shprehur këndvështrimet e tyre në diskutimet me grupet e fokusuara.

Në takimin që Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë organizoi me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, ata kanë dhënë informacione të vlefshme nga eksperiencia e tyre nga aktivitetet e të shkuarës, por edhe në ato në proces, të cilat kanë shërbyer si frymëzim për disa nga masat e Planit të Veprimit. Këto organizata kanë dhënë gjithashtu një përshkrim të aktiviteteve që planifikojnë të kryejnë gjatë periudhës 2016-2020.

Ne interes të fokusit të dokumentit tonë analizues dhe udhëzues për njësitë vendore objektivat kryesore të planit të veprimit 2016-2020 janë:

Fusha e politikës: Arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor.

Objektivi 1: Më shumë djem dhe vajza rome dhe egjiptiane që përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit.

Objektivi 2: Promovimi i dialogut ndërkulturor dhe mirëkuptimit të përbashkët përmes zhvillimit të komuniteteve mbi bazë shkolle.

Objektivi 3: Të forcohet bashkëveprimi i shkollës me shërbimet sociale, për adresimin e rasteve të fëmijëve romë dhe egjiptianë me probleme sociale-ekonomike.

Objektivi 4: Promovimi i njohjes së identitetit Rom dhe atij Egjiptian si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.

Fusha e politikës: Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP)

Objektivi 1: Integrimi i romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës nëpërmjet AFP-së dhe programeve aktive të punësimit.

Objektivi 2: Nxitja e sipërmarrjes (sociale) dhe vetëpunësimi i romëve dhe egjiptianëve.

Objektivi 3: Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i performancës së punës së punonjësve të zyrave të punësimit dhe të sistemit të arsimit dhe formimit profesional, për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës.

2.2. PUNËSIMI/PAPUNËSIA E KOMUNITETEVE ROM DHE EGJIPTIAN

Sipas një analize të Planit Kombëtar të Veprimit 2010 papunësia midis romëve është më e lartë sesa midis popullsisë jo-rome. Bazuar në një studim të Bankës Botërore, papunësia midis popullsisë rome në vitin 2002 ishte 71 përqind, ndërsa niveli kombëtar i papunësisë ishte vetëm 15.8 përqind. Rezultatet e anketimit të PNUD-it treguan që niveli i papunësisë është në përpjestim të zhdrejtë me nivelin e tyre të arsimimit. Shkalla e papunësisë për romët me arsim fillor është 39%, për ata me arsim tetëvjeçar 15% dhe përqindja e atyre që kanë arsim më të lartë është pak mbi 8%¹⁹.

Bazuar në rezultatet e anketimit të bërë nga PNUD-i rezulton se 72% e atyre që janë përgjigjur i sigurojnë rë ardhurat nga vetëpunësimi, punë të rastit ose biznese të vogla, ndërsa 13% marrin të ardhura nga pensionet, nga asistenca sociale ose kompensime papunësie, 5% nga puna në bujqësi dhe 2% nga aktivitete jo-formale si lypja²⁰. Mesatarja e të ardhurave të Romëve është

dukshëm më e ulët se ajo e popullsisë jo-Rome. Si rrjedhojë e mungesës së përgjithshme të mundësive për punësim në Shqipëri, për 92% të Romëve është e vështirë të gjejnë një punë. Shumica e kryefamiliarëve Rom nuk përfitojnë nga skemate ndihmave, pasi ata nuk janë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile, si dhe për shkak të lëvizjes së vazhdueshme nga një vend në tjetrin.

Varfëria dhe kushtet e jetesës ndikojnë drejtpërdrejt në mundësitë e fëmijëve romë dhe egjiptianë për t'u arsimuar. Prindërit që shpesh edhe vetë nuk janë të arsimuar nuk mund të ndihmojnë fëmijët e tyre me mësimet, t'u japin udhëzime ose ndajnë përvojën e tyre personale nga kjo periudhë. Më pas, pamundësia për të paguar shpenzimet e jetesës bëhet pengesë për ndjekjen e arsimit më të lartë nga të rinjtë romë dhe egjiptianë. Shpesh ata detyrohen të kërkojnë punë dhe nuk mund ta përballojnë frekuentimin e mësimet me kohë të plotë.

BASHKITË – Në Strategjinë e Mbrojtjes Sociale objektivi kryesor është garantimi i një roli kryesor të njësive të qeverisjes vendore (NJQV) në zbatimin e programeve të mbrojtjes sociale dhe atyre të përfshirjes sociale për të siguruar ofrimin e mundësive për çdo qytetar. NJQV do të përfshihen në zbatimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale (2015-2020). Kjo strategji përcakton tre fusha kryesore: **1)** Programin e ndihmës ekonomike; **2)** Programin e pagesave dhe shërbimeve për aftësinë e kufizuar si dhe **3)** Programin e ndërtimit të shërbimeve të kujdesit social¹⁶. Të tre këto programe janë programe të decentralizuara dhe ofrohen nga niveli vendor me mbështetjen e nivelit qendror.

NJQV do të përfshihen në zbatimin e Programit të Rintegritit Social dhe aplikimin e **“Punë në vend të Asistencës Sociale”** për zonat urbane dhe rurale. Do të reformohet administrimi i Programit të Ndihmës Ekonomike me qëllim që të rritet efikasiteti dhe transparenca e sistemit. Roli i NJQV në menaxhimin e Programit të Ndihmës Ekonomike do të ripërcaktohet në bazë të rezultateve të sistemit të ri të vlerësimit që do të pilotohet në 2014-2015. Përmirësimi i veprimtarisë së Fondit Social dhe krijimi i një Fondi Kombëtar për Shërbime Sociale dhe Fondet Rajonale për Shërbimet Sociale do të kontribuojnë në rritjen e burimeve financiare.

2.3. TË DHËNA PËR STRATËGJINË KOMBËTARË PËR ROMËT DHË PLANIN E VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE

Strategjia Kombëtare për romët dhe egjiptianët është paraprirë nga studime intensive të bëra nga organizata e donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Gjetjet e tyre, si në statistika ashtu dhe në analiza të faktorëve ndikues dhe vendimmarrës, kanë shërbyer për të ndërtuar shtratin e dokumenteve më të rëndësishëm që kemi sot mbi të cilët duhet të mbështeten njësitë e qeverisjes vendore dhe jo vetëm.

Sipas Raportit të UNDP 2015 bazuar në të dhënat e CENSUS 2011, thuhet që: “Specifikat demografike të popullsisë rome dhe egjiptiane dallohen dukshëm në procesin e formimit të familjeve. Kështu, martesat e hershme dhe prindërimi i hershëm janë diçka e zakonshme: në moshën 20 vjeç, 60% e femrave rome janë të martuara (dy herë më shumë sesa femrat shqiptare) dhe 43% e vajzave të moshës 18 vjeç kanë lindur një fëmijë. Struktura e njësive ekonomike familjare dhe madhësia e tyre

¹⁶ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2015-2020)
www.sociale.gov.al/.../Strategjia_Kombetare_e_Mbrojtjes_Sociale

karakterizohet gjithashtu nga një bashkëjetesë më e madhe ndërmjet brezave të ndryshëm dhe nga numri më i madh i anëtarëve”.

Janë vërejtur gjithashtu edhe modele specifike në drejtim të arsimit, ku romët dhe egjiptianët përballen me disa barriera për të ecur përpara me arsimin e tyre. Ndjekja e shkollës në nivele të ulëta dhe braktisja e hershme e shkollës çon në arritje të ulëta arsimore, dhe më konkretisht, në përhapje të analfabetizmit në të dyja këto minoritete. Një tregues shumë domethënës është përqindja e fëmijëve që nuk ndjekin arsimin e detyrueshëm. Sipas të dhënave nga Censusi, shumica e fëmijëve shqiptarë (97%) dhe egjiptianë (93%) të moshës 6 deri në 9 vjeç ndjekin arsimin fillor, por për fëmijët romë kjo ndjekje e shkollës është vetëm në nivelin 55%. Këto shifra shumë të ulëta vijnë kryesisht nga fëmijët që nuk janë regjistruar kurrë në arsim.

Shënim: Ndjekja e arsimit parashkollor nuk është pasqyruar në Census, ndërsa regjistrimi në shkolla figuron për fëmijët e moshës 6 vjeç e lart.

Studimi i PNUD-it dhe Bankës Botërore jep vlerësime për grupe të vegjël kampionësh, veçanërisht për popullatën shqiptare, por jep një ide për nivelin shumë të ulët të ndjekjes së shkollës nga fëmijët romë të moshës 5 dhe 6 vjeç (tabela 11). Nëse niveli i ndjekjes së kopshteve në zonat urbane është 53,1%, situata te fëmijët romë, ku janë regjistruar 45% prej tyre është në një nivel pak më të ulët, por jo me ndryshim të madh nga mesatarja. Nëse e krahasojmë me të dhënat nga studimi i PNUD-it dhe Bankës Botërore, ata mbeten shumë pas shifrës 82% të ndjekjes nga fëmijët shqiptarë. Një gjetje interesante është se nuk ka pabarazi gjinore në ndjekjen e arsimit parashkollor.¹⁷

Meqë qëllimi i këtij dokumenti janë trajtimi i fëmijëve rom dhe krijimi i kushteve për të ndjekur arsimin parashkollor, po fokusohemi tek pjesa e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për këtë. **Strategjia Kombëtare për Romet** nis duke u bazuar në një sërë parimesh, ku më vonë është bazuar edhe Plani i Veprimit 2016-2020 për fëmijët romë dhe egjiptianë. Më konkretisht:

Edukimi i fëmijëve parashkollorë do të realizohet nëpërmjet: **(i)** evidentimit të numrit të fëmijëve që duhet të frekuentojnë kopshtet; **(ii)** evidentimit të frekuentimit të kopshteve nga fëmijët romë; **(iii)** sensibilizimit të opinionit rom për domosdoshmërinë e regjistrimit të fëmijëve rom në kopshte; **(iv)** evidentimit të kapaciteteve thithëse të objekteve parashkollore në zonat ku banon minoriteti rom dhe sugjerime për të ardhmen, **(v)** rikonstruksionin e kopshteve që janë në gjendje jo të mirë në zonat ku banon komuniteti rom; **(vi)** ngritjen e objekteve të reja në zonat ku aktualisht nuk ka kopshte për fëmijë sipas nevojave që lidhen me numrin e fëmijëve; **(vii)** domosdoshmërisë së mësimin të gjuhës shqipe për grupin e tretë të arsimit parashkollor për t'i përgatitur fëmijët për klasën e parë; si dhe **(viii)** emërimin e edukatoreve me përvojë duke marrë më parë mendimin e minoritetit.

Pavarësisht se kjo Strategji është e hershme dhe Plani i Veprimit është i fokusuar në masat për integrimin në përgjithësi të komuniteteve rom dhe egjiptian (përfshirë fëmijët), masat e propozuara nga strategjia sa i përket arsimimit të tyre mbesin aktuale.

Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 vjen si një dokument politik i qeverisë shqiptare që adreson problematikat dhe çështjet kryesore që ndikojnë në jetën e komuniteteve rome dhe egjiptiane duke krijuar shpeshherë diferenca në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë.

¹⁷ Census 2011 “Profili i Romeve dhe Egjiptianeve final” 2015, fq 25.

Ky Plan Veprimi ngrihet gjithashtu mbi dokumentet e mëparshme të politikave specifike që nxisin përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Në vitin 2003, qeveria miratoi *Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom 2003-2013*, të ndjekur nga *Plani Kombëtar i Veprimit për Romët 2010-2015* që u miratua pas aderimit të vendit në Dekadën e Përfshirjes Rome. Këto dokumente janë përdorur për të udhëhequr programet publike që synojnë të përmirësojnë statusin e romëve dhe egjiptianëve.

2.4. FINANCIME APO BUXHETIME NË NIVEL KOMBËTAR

Plani i Veprimit përfshin një buxhet për zbatimin e çdo veprimtarie. Në varësi të llojit të veprimtarisë, Plani i Veprimit specifikon:

1. *Financimin nga qeveria* për masat që kanë si objekt të qartë romët dhe egjiptianët ose që vijnë nga buxheti i përgjithshëm dhe kontribuojnë në përpjekjet për integrimin.
2. *Financimi nga donatorët* për kostot që nuk mund të mbulohen nga buxheti i qeverisë. Ky financim mund të kanalizohet përmes organeve shtetërore ose organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbimet në fushën e caktuar.
3. *Kombinimi i financimit nga qeveria dhe financimit nga donatorët.*
4. *Asnjë kosto* – kur nuk nevojitet financim shtesë për zbatimin e veprimtarive ose kjo gjë mund të arrihet duke përdorur burimet ekzistuese (të përgjithshme) të qeverisë.

Shërbimet sociale edhe për shtete të pasura dhe me një traditë të konsoliduar janë të limituara apo në përgjithësi mund të themi se janë të kushtueshme. Për hir të rrethanave por dhe për këtë arsye shikohet një diversifikim i mbulimit të shpenzimeve në këtë pikë si nga institucione vendase ashtu dhe nga organizama të huaj dhe donatorë e agjensi të ndryshme bamirësie.

Kur diskutohet çështjet e mos diskriminimit dhe rritjes së peshës në vendimmarrje apo edhe tema të kujdesit dhe mbështetjes sociale për romet dhe egjiptianët roli i donatoreve, mbulimi i shpenzimeve të projekteve nga ana tyre është determinues. Reforma e territorit dhe strategjia e decentralizimit pretendon që roli i njësive vendore të vijë në rritje si në soft projekte ashtu dhe në infrastrukturë shërbimesh dhe jo vetëm.

2.5. ROLI I QEVERISJES VENDORE

2.5.1. Strategjia e Decentralizimit

Në maj 1998, Shqipëria nënshkroi Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore. Ligji Nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore në Shqipëri” çoi përpara dhe zhvilloi më tej vetëqeverisjen vendore, që ekzistonte tashmë që prej vitit 1992. Po kështu, reforma Administrative Territoriale, Strategjia e Decentralizimit e miratuar në korrik 2015, si dhe Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” kanë sjellë një klimë të re në qeverisjen vendore. Ato, së bashku me funksione të mëparshme shtetërore që iu transferuan qeverisjes vendore, përbëjnë një hap domethënës në rrugën për rritjen e autoritetit vendimmarrës e administrativ të njësive vendore në përgjithësi dhe të zgjedhurve vendorë në veçanti.

Pas Reformës Administrative Territoriale të vitit 2014 u krijuan kushte të transferimit të funksioneve dhe kompetencave të tjera në qeverisjen vendore. Ajo tashmë ka kapacitetet e duhura ose më mirë të

themi ka potencialet e duhura për të menaxhuar më mirë në mënyrë efikase dhe eficiente funksionet e veta. Për të ecur në mënyrë strategjike në decentralizimin e funksioneve dhe kompetencave u bë e nevojshme të ndërtohet një strategji për decentralizimin, e cila do ishte një strategji që afekton apo implikon shumë institucione të qeverisjes qendore që do të transferonin apo delegonin kompetencat e tyre në njësitë e qeverisjes vendore. Në korrik 2015 qeveria miratoi Strategjinë Ndersektoriale të Decentralizimit 2015-2020. Kjo strategji, ka përfshirë në planin e veprimit parimet dhe objektivat e strategjisë për mbrojtjen sociale.

Vizioni i Strategjisë për mbrojtjen sociale synon një shoqëri në të cilën individët dhe grupet më vulnerabël dhe të përjashtuar, duke filluar që nga lindja dhe përgjatë moshës së rritur dhe më tej në moshën e tretë, të jenë të mbrojtur dhe në gjendje për të marrë pjesë tërësisht në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë.

Funksioni i ofrimit të shërbimeve sociale vendore është decentralizuar dhe akoma do të decentralizohet dhe do të kalojë në kompetencë të bashkive. Në çdo bashki do të krijohen zyrat e shërbimeve sociale të integruara të cilat do të sigurojnë identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e individëve dhe familjeve në nevojë përmes programeve të ndihmës ekonomike dhe të kujdesit social. MMRS do të mbështesë me kapacitete dhe mjete NjQV-të për hartimin e Planeve Vendore të Shërbimeve Sociale. Bashkitë do të kenë kompetencë të ofrojnë shërbime sociale përtej “shportës të shërbimeve bazë”, të cilat do të sigurojnë mbështetjen për nevoja specifike në bazë të vlerësimit të nevojave.

Bashkitë do të mbështeten për përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese dhe cilësisë së *shërbimeve sociale* në lidhje me institucionet residenciale, qendrat ditore, qendrat komunitare, shtëpitë e të moshuarve, etj., të cilat do të jenë pjesë e prioritetëve të qeverisë në sektorin social. NjQV do të mbështeten për të ndërtuar shërbime cilësore dhe të mbështetura në standarde cilësore të shërbimeve, trajnimit dhe kualifikimit në vazhdimësi të figurave profesionale të shërbimeve sociale si dhe përmes një mekanizmi financiar (Fondi Social i Shërbimeve)

Reforma në shërbimet sociale do të lidhet ngushtësisht me rolin e ri të qeverisjes vendore pas Reformës Administrative Territoriale. Bashkitë e reja do të jenë aktori kryesor në ofrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor, duke plotësuar një vakum të madh midis pritshmërisë së qytetarëve për shërbime sociale dhe kapaciteteve ofruese të qeverisë vendore. NjQV të mbështetura nga MMRS do të hartojnë planin e deinstitutionalizimit të shërbimeve rezidenciale në transformimin e tyre në modele të vendit të banimit në shërbime me bazë komunitare dhe familjeje.

Do të synohet mbështetja e modeleve miks të shërbimeve sociale, ku kombinohet ofrimi i shërbimeve sociale drejtpërdrejt nga shteti, organizatat jo-fitimprurëse dhe ofruesve privatë të shërbimeve. Kjo do ta rivitalizonte dhe rrisë bashkëpunimin dhe partneritetin me organizata jofitimprurëse dhe biznesin për ofrimin e shërbimeve sociale.

Përfshirja sociale. Qeveria shqiptare ka përcaktuar një vizion të qartë për politikën e përfshirjes sociale duke theksuar se qëllimi i politikave të përfshirjes sociale në nivel qendror dhe lokal është t’u mundësojmë të gjithë shqiptarëve një akses të pakufizuar në shërbime publike të cilësisë së lartë, për të lehtësuar dhe mbështetur pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri, pavarësisht nivelit të të ardhurave,

gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, origjinës etnike, orientimit dhe identitetit seksual, vendbanimit ose bindjeve fetare.

Çdo bashki do të mbështetet në hartimin e planit të përfshirjes sociale në koordinim me politikën kombëtare të përfshirjes sociale për të siguruar që çdo individ apo grupi të përjashtuar t'i sigurohet aksesimi dhe cilësia e shërbimeve publike, pjesëmarrja në vendimarrje, si dhe mundësitë e barabarta. Këto planë do të jenë të kordinuara dhe bashkërenduara edhe me institucionet e tjera vendore.

Në **Strategjinë e Decentralizimit** janë përfshirë këto aktivitete në kuadër të rritjes së kompetencave dhe kapaciteteve të njësive vendore në fushën e funksioneve dhe shërbimeve sociale:

1. Rishikimi i ligjit të “Strehimit Social” dhe mbështetja për hartimin e planeve të strehimit social në nivel vendor. (2015-2016)
2. Rishikimi i legjislacionit sektorial për decentralizimin e plotë të skemës së shërbimeve sociale dhe përmirësimin e përfshirjes sociale në nivel vendor. (2017-2018)
3. Përmirësimi i mekanizmave për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror, sipas procedurave standarde të veprimit dhe metodologjive. (2017-2018)
4. Shqyrtimi i listës së shërbimeve sociale që do të ofrohen nga NJQV-te duke prezantuar dhe shpjeguar tipologjinë e shërbimit të ri. (2015-2016)
5. Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimeve dhe kostove për njësi (2015-2016)
6. Krijimi i sistemeve të integruara të shërbimeve në nivel rajonal/vendor, bazuar në standardet e shërbimeve sociale për të gjitha grupet. (2017-2018)
7. Ngritja e kapaciteteve të NJQV-ve për planifikimin e shërbimeve sociale (duke përfshirë identifikimin, menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e sistemit të shërbimeve sociale). (2017-2018)
8. Rritja e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit social. Krijimi i profileve profesionale si dhe zbatimi i programit të kualifikimit të vazhdueshëm.(2016-2018)
9. Hartimi i përshkrimeve të punës për punonjësit social dhe kompetencat e nevojshme dhe aftësitë që kërkohen.(2015-2020)

Është e qartë, që brenda kësaj game të shërbimeve sociale janë të përfshira edhe aktivitetet për grupet vulnerabël të komuniteteve romë dhe egjiptiane, aktivitete këto që në mbështetje të Planit të Veprimit 2016-2020 do të japin linjat e veprimit të njësive vendore në përmbushje të detyrimeve të tyre për këtë pjesë të komunitetit.

2.5.2. Ligji ri “Për Vetëqeverisjen Vendore”

Pas Reformës së Territorit, pasi u miratua Strategjia e Decentralizimit së bashku me planin e veprimit për zbatim 2015-2020, në dhjetor 2015 u miratua Ligji No.139/2015 ‘Për Vetëqeverisjen Vendore’. Ky ligj organik shtrën platformën e kompetencave për ushtrimin e autoritetit nga njësitë vendore, ka lidhje dhe me legjislacionin sektorial, me standardet kombëtare dhe lokale, me mënyrën e ofrimit të shërbimeve, si dhe me një sërë aktesh ligjore e nënligjore që afektojnë zbatimin e këtyre funksioneve në nivel vendor. Në këtë ligj përcaktohet qartë misioni i qeverisjes vendore si një detyrim për të siguruar qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;

- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Detyrimi i njësive vendore për të ndjekur politika kombëtare në ushtrimin e funksioneve të tyre përcaktohet në Nenin 22 të Ligjit 139/2015 ku thuhet: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione, qeverisja qendrore mund të vendosë standarde e norma specifike të përgjithshme, me qëllim ruajtjen e interesave kombëtarë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore”.

Bashkitë kanë kompetenca në ofrimin e shërbimeve sociale. Ligji parashikon që bashkitë kanë kompetenca në:

1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2.5.3. Roli i strukturave vendore në zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020

Bashkitë gjenerojnë burime dhe kapacitete të rëndësishme për zbatimin e aktiviteteve të nxitjes së integritetit të komuniteteve rome dhe egjiptiane. Deri tani, ka disa bashki që kanë hartuar planet e tyre të veprimit në këtë fushë, dhe ku kanë caktuar prioritetet të indentifikuara në bashkëpunim me popullsinë rome dhe egjiptiane. Nga ana tjetër, vetë bashkitë mund të zgjedhin që të hartojnë plane lokale veprimi për përfshirjen sociale ose mbrojtjen sociale, ku integrimi i romëve dhe egjiptianëve të jetë objektivi kryesor, por edhe grupe të tjera mund të përfshihen në të.

Gjithashtu, Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e masave të Planit Kombëtar të Veprimit në të gjithë sektorët. Në sajë të rritjes së përgjegjësisë të pushtetit vendor bazuar në reformat e decentralizimit dhe administrimit territorial, ministrinë parashikojnë një bashkëpunim më të ngushtë me Bashkitë për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit.

E rëndësishme është të shfrytëzohen hapësirat ligjore të ligjit organik, të ndërtohen strukturat komunitare të komuniteteve përkatëse rome dhe egjiptiane, të rritet komunikimi me faktorët relevant të shoqërisë civile, si dhe të koordinohen veprimet me donatorët që operojnë në këtë fushë. Këshillat vendor kanë një rol domethënës në këtë proces. Në bazë të Nenit 54 të Ligjit për Vetëqeverisjen

Vendore, këshillat miratojnë rregullore për funksionet e dhëna vendore në mbrojtje të interesit publik. Për pasojë, këshillat vendore duhet të aprovojnë një plan veprimi vendor në mbështetje të planit kombëtar, i cili të specifikojë objektivat brenda mandatit që ka këshilli, të përfshijë në planet e përgjithëshme vendore aktivitetet përkatëse në kuadër të shërbimeve sociale me fokus këto komunitete dhe të buxhetojë vit pas viti aktivitetet që mbështesin përpjekjet dhe nevojat për të arritur objektivat.

3. PJESA E TRETË

3.1. STRATEGJITË/PLANET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT NË NIVEL VENDOR – SITUATA NE ROSKOVEC

Në shumë shtete, bashkitë zotërojnë ose kontrollojnë një sasi të konsiderueshme ndërtesash duke përfshirë, por jo vetëm, ndërtesat publike, shkollat, klinika të shërbimit shëndetësor parësor, rrugë, dhe sheshe publike. Komunitete të ndryshme kërkojnë strehim, shkollim dhe shërbime shëndetësore cilësore për të krijuar mundësi dhe mirëqenie sociale për rezidentët e tyre.

Megjithëse shumë qeveri vendore përpiqen të menaxhojnë asetet e tyre të paluajtshme, shumë pak e konsiderojnë këtë paketë asetesh si një ‘portofol’ (tërësia e asetëve të prekshme të përdorura për realizimin e shërbimeve sociale) ose si aset produktive. Nëse një aset përdoret për një funksion thelbësor në përmbushjen e mirëqenies sociale, në krahasim me një shërbim që është minimalisht i dëshiruar nga pikëpamja e standardeve sociale, atëherë ai aset duhet të klasifikohet si aset ‘i rëndësishëm që duhet të mbesin nën pronësinë e bashkisë, me destinacion përdorimi të përcaktuar qartë, për të siguruar integritetin e asetit në të mirë të komunitetit sot dhe në të ardhmen.

Një nga sfidat kryesore punës së qeverisjes vendore është riorientimi i programeve sociale drejt grupeve në pozita të pafavorizuara. Vëmendja duhet të përqëndrohet tek grupet e përjashtuara të cilat deri tani kanë patur shumë pak gjasa për të përfituar nga programet e strehimit social. Kjo kërkon një mobilizim të burimeve vendore, por edhe një ndryshim të shpërndarjes së buxhetit. Deri tani, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për strehim është alokuar për një prej programeve nga i cili ka më shumë gjasa të përfitojë shtresa e mesme. Ky ndryshim kërkon vullnet politik, por edhe një rritje të ndërgjegjësimit të njesisë vendore për të alokuar burime në mbështetje të programeve të strehimit social.

Për të adresuar këto probleme është hartuar së fundmi Strategjia e Strehimit Social 2016-2025, zbatimi i së cilës do të gërshetohet me strategji dhe dokumenta të tjerë, në mënyrë të veçantë me Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 dhe Dokumentin Politik të Përfshirjes Sociale 2015-2020.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore përcakton se NJQV-të “kanë përgjegjësi për planifikimin urban, menaxhimin e tokës dhe strehimin duke angazhuar fondet e tyre, buxhetin e shtetit, fondet e donatorëve apo të partneriteteve private-publike për programet e strehimit social, strehimin me kosto të ulët apo për infrastrukturën e tokës” (fq. 12). Kjo Strategji thekson rëndësinë e mbështetjes në partneritetin publik-privat “si një mundësi e NJQV-ve për financimet private me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të infrastrukturës publike dhe asetëve vendore” (fq. 12).

Njëkohësisht, ajo përcakton se bashkitë do të hartojnë plane 10-vjeçare të strehimit social si dhe do të planifikojnë fonde për strehimin social. Qeveria qendrore do të ofrojë mbështetje sidomos në forcimin e kapaciteteve të bashkive për administrimin e kërkesave për strehim social dhe menaxhimin e stokut të banesave sociale.

Ndërkohë në nivel kombëtar, përqindja më e ulët e përfituesve të strehimit social u përket grupeve të jetimëve, egjiptianëve dhe familjeve me kryefamiljare femra. Sipas kësaj Strategjie, (Burimi: UNDP 2014b), numri i kërkuarve (familje) rom është 43, ndërsa ai i përfituesve (familje) 16 ose 37,2%. Numri i kërkuarve (familje) egjiptiane 365, ndërsa ai i përfituesve (familje) është 41 ose 11,2%. Kjo tregon për numrin e ulët të strehimit social, pavarësisht që numri real i njerëzve që kanë nevojë për strehim është shumë më i lartë.

Në Planin Operacional të Zhvillimit Lokal të bashkisë Roskovec (shkurt 2016) ka të dhëna për aktivitetin e operatorëve ekonomik të kësaj bashkësie, për demografinë dhe shërbimet e ndryshme të cilat indirekt japin edhe të dhëna për komunitetet romë dhe egjiptiane.

Popullsia e zonës së qarkut Fier ka përqindje më të lartë të popullsisë që jeton në nivelin e varferisë krahasuar me mesataren kombëtare (17.1% krahasuar me 14.3%), dhe ashpersi të saj në nivelin mesatar kombëtar (1.0, hendeu 3.4 krahasuar me 3.0 që është niveli mesatar).¹⁸.

Bashkia e Roskovecit ka disa institucione të arsimit dhe edukimit para-shkollor, 2 shkolla të mesme publike dhe 1 shkollë e mesme private (kjo e fundit gjithashtu permban klasa të arsimit dhe nëntëvjeçar) 12 shkolla publike të arsimit 9-vjeçar, 4 shkolla fillore dhe 16kopshte/çerdhe. Tabela 5 paraqet numrin e institucioneve të arsimit në BashkinëRoskovec.

Tabela 5: Institucionet e Arsimit

Bashkia Roskovec	Shkolla te Mesme	Shkolla 9-vjeçare	Shkolla fillore	Kopshte/Çerdhe
Shkolla Publike	2	12	4	16
Shkolla jo-Publike	1	-	-	-
Totali	3	12	4	16

Burimi: Bashkia Roskovec

Numri mesatar i nxënësve për klasë në shkollat në juridiksion të Bashkisë Roskovec është rreth 20 nxënës, me një shpërndarje nga 13 deri në 30 nxënës për klasë, dhe raporti i ndjekjes së shkollës sipas gjinisëështë 50%. Nuk ekziston fenomeni i braktisjes së shkollës, ndonese janë evidentuar 17 raste (2015, nxënës të moshave të ndryshme) për arsye të migrimit, kushteve të vështira ekonomike si dhe largësia e vendit banimit nga shkolla. Bashkia Roskovec nuk ka shkollë profesionale por është hapur dhe funksionon një qendër jopublike për mësimin e gjuhëve të huaja.

Pavarësisht analizës së bërë në Planin Operacional të Zhvillimit Lokal të Bashkisë Roskovec, sërish mungon një analizë e theksuar dhe e detajuar për komunitetin rom dhe egjiptian. Nëse Roskoveci ka një profil varfërie të tillë të prezantuar si më sipër në analizë, atëherë është e qartë edhe problematika e kësaj shtrese. Por nëse kjo strategji nuk përfshihet në analizë me objektiva për t'u arritur përmes projekteve dhe programeve, atëherë do të mungojë edhe vëmendja e programuar, do mungojnë parashikimet strategjike buxhetore vjetore dhe afatmesme. Zgjidhjet për këtë shtresë bëhen tepër të vështira larg vëmendjes së shpenzimeve të programuara.

¹⁸Burimi: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, AMNJ 2012

Gjithsesi në Planin Operacional mund të gjejmë analiza të tilla dhe konkluzione si:

- Në bashki nuk ka forma jashtë institucionale të mbrojtjes sociale dhe nuk është i zhvilluar veprimi qytetar;
- Vëmendje ndaj programeve politike në zhvillimin e mëtejshëm të formimit profesional për përmirësimin e kualifikimit të forcës së punës në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Këto programe të formimit profesional do të jenë të orientuara nga grupe në nevojë si gratë me AK, grate romë dhe egjiptiane, gratë e dhunuara, etj;

Nisur nga këto gjetje bashkia ka vendosur që në Drejtimin Strategjik të saj in nr.2 të përfshijë: *Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës sociale – zhvillimi i arsimit dhe institucioneve arsimore, përmirësimi i shërbimit shëndetësor dhe kujdesit social dhe rivitalizimit të jetës kulturës dhe sportive.*

Kjo strategji pavarësisht se nuk i adresohet në mënyrë eksplicite komunitetit rom dhe egjiptian sërish në objektivat e drejtimin strategjik që po i radhisim më poshtë mund të nënkuptohet edhe trajtimi i nevojave për komunitetet në fjalë. Objektivat janë si më poshtë:

- Të sigurojë që të gjithë fëmijët parashkollorë të marrin shërbimin e kontrollit shëndetësor dhe imunitar;
- Të gjithë fëmijët e moshës 5 vjeçare të kenë akses në shërbimin e arsimit parashkollor;
- Të rritet numri i nxënësve që përfitojnë nga kabinete të plotësuara;
- Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave dhe mirembajtjes së tyre;
- Të sigurohet 100% përfundimi i arsimit të detyrueshem në 2020;

Nën-drejtime strategjike përfshijnë:

- Rehabilitimi i qendrave shëndetësore dhe ambulancave, si dhe rritja e personelit mjekësor ndihmës;
 - Transformimi i poliklinikës së Roskovecit në spital që do të ofronte shërbim spitalor për banorët (femrat gjithashtu);
- Përmirësimi i institucioneve të arsimit dhe shëndetësisë
 - Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave me problem;
 - Përmirësimi i bazës materiale, laboratorëve për të rritur cilësinë e arsimit dhe transformimin shkollave në qendra komunitare;
 - Ndërtimi i palestres së gjimnazit në Roskovec dhe përmirësimi i infrastrukturës së palestrave dhe oborreve të shkollave të tjera, me qëllim afrimin e të rinjve dhe të rejave drejt sporteve;
- Mbështetje për punësim dhe trajnim profesional në bashkepunim me Zyrën Rajonale të Punës, e orientuar drejt grupeve në nevojë;
- Mbështetje në organizimin e veprimtaritë historike dhe edukative kushtuar ngjarjeve dhe figurave të rëndësishme lokale;

Krahasuar sa më sipër mund të themi që në raportin e BE/OSBE për antidiskriminimin dhe pjesëmarrjen në vendimarrje prezantohen rekomandime nga gjetje dhe praktika më të mira për Ballkanin Perëndimor. Këto gjetje dhe rekomandime, së bashku me qëllimet dhe objektivat e Planit të Veprimit, si dhe Strategjinë për Integrimin e Romëve duhet të kihen parasysh në bashkinë Roskovec që të përfshihen si në analizën e Planit të Përgjithshëm Lokal për Zhvillimin e Territorit, po ashtu edhe në objektivat dhe në buxhetet përkatëse.

Ky më poshtë është shembull nga raporti i BE/OSBE për antidiskriminimin.

Rekomandime: Antidiskriminimi

Rekomandimet e mëposhtme janë një përpjekje për të veçuar mësimet e nxjerra nga praktikat e mira në Ballkanin Perëndimor, si dhe nga ato më pak të suksesshme, dhe për t'i futur ato në udhëzimet për hartimin e praktikave të mira të nivelit lokal në fushën e antidiskriminimit.

1. Të ndahen politikat dhe praktikat lokale nga politikat qendrore kundër diskriminimit.
2. Të rritet ndërgjegjësimi në lidhje me diskriminimin si problem dhe për mjetet për ta luftuar atë;
3. T'i jepet përparësi shtrirjes së veprimit të institucioneve qendrore të antidiskriminimit në nivel lokal në formën e krijimit të institucioneve të reja lokale.
4. Të përmirësohen procedurat dhe qasja ndaj mjeteve juridike për diskriminim në mënyrë që ato të marrin parasysh situatën e vështirë dhe komplekse ligjore me të cilën përballen shpesh Romët, dhe
5. Të trajtohen llojet e shumëfishta të diskriminimit me të cilin ballafaqohen gratë dhe vajzat rome.

Rekomandime: Pjesëmarrja në vendimmarrje

Njësoj si rekomandimet në fushën e antidiskriminimit, rekomandimet në vijim bazohen në sukseset dhe dështimet e nismave të derisotme në Ballkanin Perëndimor, me qëllim gjenerimin e praktikave të mira në nivel lokal.

1. Të përfshihen Romët në nisma, të cilat i prekin Romët drejtpërdrejt;
2. Të planifikohen politika për të adresuar nevojat lokale të komunitetit duke mbajtur parasysh prioritetet e vendosura në nivelet më të larta;
3. Të sigurohen mjete për zbatim;
4. Të rritet numri i bashkëbiseduesve të aftë përmes programeve të orientuara drejt trajnimit dhe investimit afatgjatë në arsim;
5. Të sigurohet prani e qëndrueshme dhe aktive e grave rome në vendimmarrje.

3.1. FËMIJET ROME DHE EGJIPTIAN NE KETO STRATEGJI - RASTI I ROSKOVECIT

Në kuadrin e ngritjes së kapaciteteve të institucioneve qeveritare me qëllim hartimin e politikave që garantojnë të drejtat e fëmijëve, si edhe vëzhgimin e zbatimit të tyre është ngritur dhe duhet të funksionojë brenda strukturës administrative të qarkut, njësia për të drejtat e fëmijës (NJDF). Me ndryshimet strukturore në këtë vit ku në të gjithë qarqet janë shkurtuar strukturat e këtyre njësive të nivelit të dytë (kanë ngelur afërsisht 1/3 e strukturave) nuk dihet efikasiteti i tyre. Sipas parashikimeve në momentet e strukturimit kjo njësi kishte/ka për detyrë:

1. Të vëzhgojë dhe vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në nivel rajonal;
2. Të identifikojë rastet e shkeljeve apo abuzimit, keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve;
3. Të mbledhë informacion vazhdimisht dhe periodikisht mbi treguesit e matjes dhe vlerësimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajonal;
4. Të marrë pjesë në projekte studimore që synojnë matjen dhe vlerësimin e treguesve të të drejtave të fëmijëve;
5. Të bashkëpunojë dhe këmbëjë informacion me zyrën e statistikave, drejtorinë rajonale të shëndetit parësor, drejtorinë rajonale të arsimit, zyrën e regjistrimit të gjendjes civile, zyrën e ndihmës dhe shërbimeve sociale në bashki si edhe çdo institucion tjetër të qeverisjes vendore apo shoqërisë civile, me qëllim njohjen dhe identifikimin e çështjeve ligjore dhe institucionale që lidhen me të drejtat e fëmijëve;

6. Të koordinojë dhe marrë pjesë në hartimin e propozimeve për përmirësime/ndryshime legislative apo institucionale që ndikojnë në rritjen e efektivitetit të politikave sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
7. Të koordinojë dhe marrë pjesë në hartimin e “raportit të ecurisë” të strategjisë kombëtare për fëmijë si edhe të planit rajonal të veprimit për fëmijë;
8. Të raportojë periodikisht dhe në mënyrë të vazhdueshme tek prefekti, kryetari i këshillit të qarkut si edhe drejtori i përgjithshëm i shërbimit social shtetëror mbi zbatimin e detyrave të mësipërme.

Në zbatim të Ligjit Nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” neni 38, 39, VKM Nr. 266, datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve”, Bashkia është e detyruar të ngrejë **Njësine për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**.

Në zbatim të nenit 3 të VKM Nr. 266, datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve”, mes Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës në nivel lokal, Bashkia do të ketë një bashkëpunim i cili do të konsistojë në:

- **Monitorimin** e zbatimit të detyrave të përcaktuara në nenet 38,39 të ligjit Nr. 10347 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”,
- **Caktimin** e një personi përgjegjës për zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve,
- **Mbledhjen** e të dhënave statistikore në zbatim të legjislacionin për të drejtat e fëmijëve, në lidhje me gjendjen e të drejtave të fëmijës në territorin e bashkisë përkatëse,
- **Shkëmbimin** e informacioneve çdo 6 muaj lidhur me aktivitetet, situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijëve, problematikat si dhe propozimet konkrete për mbështetje nga institucionet qendrore,
- **Rritjes** së kapaciteteve të punonjësve dhe funksionareve të administratës publike në shërbim dhe zbatim të kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve,
- Orientimin e organizatave jofitimprurëse që kanë për qëllim zbatimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta që kanë si qëllim mbrojtjen e fëmijëve në rrezik, Ministria përgjegjëse bashkëpunon me njësite në nivel vendor lidhur me:
- Regjistrimin e fëmijëve në shërbimin e gjendjes civile si dhe me identifikimin e problematikave lidhur me shërbimet sociale, shëndetësore,
- Pjesëmarrjen në takimet e grupeve me qëllim bashkërendimin e punës mes autoriteteve shtetërore përgjegjëse për menaxhimin e fëmijëve në rrezik,
- Kualifikimin e personave përgjegjës për çështjen në fjalë.
- Kryerjen e studimeve dhe projekteve që kanë si qëllim përmirësimin e gjendjes së fëmijëve
- Shkëmbimin e informacionit të dhënave statistikore dorëzimin e këtyre të fundit pranë Agjencisë Shtetërore të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Me aktet ligjore dhe nënligjore së fundmi puna e bashkive dhe e DAR/ZA sa i përket çështjes së fëmijëve rom dhe egjiptian kërkon **Bashkërendim, Planifikim, Buxhetim, Monitorim**, dhe së fundi **Raportim** pranë strukturave vendore dhe qendrore, si dhe grupeve të interesit. Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet do përpiqemi t’i parashtrojmë në pjesën e katërt të këtij dokumenti.

4. PJESA E KATËRT

GJETJE DHE REKOMANDIME

Për hartimin e kësaj pjese të dokumentit është synuar dhe siguruar një proces konsultimi me përfaqësues romë dhe egjiptian në nivel lokal, OJQ të përfshira në çështjet e të dy komuniteteve, si edhe me autoritetet lokale (Bashki, Qark, Prefekturë) apo kombëtare që operojnë në Bashkinë Roskovec (Drejtoria Rajonale e Arsimit, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik, Zyra Rajonale e Punësimit). Si rezultat i këtyre takimeve është bërë një skanim i situatës aktuale, janë evidentuar problemet dhe nevojat për t'u adresuar, mundësitë për ndërhyrje, si dhe janë përcaktuar fushat prioritare. Bazuar në takimet individuale dhe tryezat e rrumbullakëta, gjetjet ne lidhje me situatën e këtij komunitetit paraqiten si më poshtë:

4.1. ANALIZA E SITUATËS

Pas Reformës Administrative Territoriale Bashkia e re e Roskovecit përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Roskovec, Kuman, Kurjan dhe Strum. Të gjitha këto njësi janë aktualisht pjesë e qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj vetëm një qytet (Roskovecin) dhe 14 fshatra. Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re Roskovec ka 21.742 banorë, në Regjistrin Civil popullsia e regjistruar figuron 31.548 banorë, ndërsa shifrat e sakta për popullsinë rome dhe egjiptiane mungojnë. Ata janë të vendosur kryesisht në qytetet e Roskovecit dhe pak nëpër fshatra.

Të dhënat e *Social Inclusion Data for Children in Albania 2011, Roma Communities* (13 familje, 157 banorë dhe 52 fëmijë) nuk përkrijnë më të dhënat në terren. Sipas intervistave dhe takimeve me aktorë të ndryshëm lokal, komuniteti rom zë rreth 3% të popullsisë së qytetit të Roskovecit (102 familje), ndërkohë që mungojnë statistikave për këtë komunitet në njësitë administrative. Në këto shifra nuk janë përfshirë romët që jetojnë në



njësitë administrative, që ndodhen jashtë vendit për arsye emigrimi, si dhe ata që kanë migruar brenda vendit për arsye pune ose janë shpërngulur për të jetuar në një vend tjetër të Shqipërisë.

Komuniteti rom në Bashkinë Roskovec është i mirë pranuar dhe i integruar, për shkak edhe të historisë së bashkëjetesës që para viteve të demokracisë. Nuk ka dhunë ndaj tyre, por si në gjithë vendin ekziston paragjykim dhe diskriminim jo i hapur dhe i drejtpërdrejtë. Në përgjithësi komuniteti është i stabilizuar dhe ka pak levizje që konsistojnë në emigrim apo migrim të brendshëm.

Mungojnë statistikën e sakta për punësimin e tyre, sidomos në institucionet shtetërore dhe vendore. Sipas intervistave, rreth 10 romë janë të punësuar në ndërmarrjen e pastrimit, që ze rreth 3% të të gjithë të punësuarve në bashki apo në ndërmarrjet në varësi të saj. Punësimi i tyre mendohet të jetë i papërfillshëm duke patur parasysh që kryesisht ata janë të vetëpunësuar në tregun informal.

Ka praktika të mira nga ana e bashkisë përse i takon integritet të këtij komuniteti. Për vitin 2016 është miratuar një fond për rikonstruktimin e 40 banesave të familjeve romë. Është planifikuar ndërtimi i një kopshti me kapacitet prej 100 fëmijësh, që do të frekuentohet edhe nga fëmijët romë. Në panairin lokal që u organizua në muajin korrik nga Bashkia Roskovec morën pjesë edhe 3 romë me produktet e tyre artizanale. Një rast specifik ndihme nga ana e bashkisë është mbështetja për rregullimin e shtëpisë së një familjeje romë e cila u dogj. Është planifikuar edhe rregullimi i rrugës për Kurjan që rregullon edhe çështjen e mobilitetit për 10 familje romë të vendosura aty. Romët nuk janë të përfaqësuar në institucionet vendimarrëse (nuk ka asnjë anëtarë të këshillit bashkiak (21) nga ky komunitet). Ka vetëm një organizatë lokale që merret me çështjen romë.

Nga 137 fëmijë në kopsht 9 prej tyre janë romë. Përgjithësisht fëmijët romë në territorin e Bashkisë Roskovec janë të regjistruar dhe të vaksinuar, ndërkohë që ka ende shumë për të bërë për identifikimin dhe regjistrimin e atyre që nuk e kanë bërë akoma. Një rol të rëndësishëm në këtë fushë ka luajtur edhe iniciativa “Çdo fëmijë Rom në kopsht” të mbështetur nga UNICEF, që e ka çuar numrin e fëmijëve që frekuentojnë kopshtin në tre vitet e fundit në 9. Si rezultat i projektit dhe i bashkëpunimit dhe bashkërendimit institucional familjet romë kanë filluar të regjistrojnë fëmijët e tyre në gjendjen civile, që ka shërbyer si mjet për nxitjen e regjistrimeve në kopsht; ka ulur diferencimin dhe diskriminimin e fëmijëve romë dhe ka rritur gatishmërinë e mësuesve të kopshteve për përmirësimin e metodave mësimore për nxitjen dhe sjelljen e këtyre fëmijëve në kopsht.

Bashkia e Roskovec ka një Plan Operacional të Zhvillimit Lokal, Shkurt 2016, në të cilët kishte një nëndrejtim strategjik (infrastruktura sociale) që lidhej me integritetin e komunitetit romë. Bashkia Roskovec është në pritje të hartimit të një Strategjie të Zhvillimit të Territorit si pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit dhe nuk hartuar ende një Plan Vendor Veprimi për Integritetin e Romëve, të cilat janë dokumente shumë të rëndësishme orientuese për hartimin dhe planifikimin e politikave lokale në kuadrin e Reformës Administrative Territoriale dhe funksioneve të reja që i kanë kaluar Bashkisë.

4.2. PROBLEMATIKAT DHE NEVOJAT

Kryesisht problematikat dhe nevojat e këtyre komuniteteve lidhen me katër fusha, si më poshtë:

4.2.1. Arsimi

Arsimimi mbetet një çështje e mprehtë për këtë komunitet. Ka probleme të analfabetizmit, të mos regjistrimit dhe mos frekuentimit të shkollave. Shkaqet e nivelit të ulët të arsimimit të këtij komuniteti janë të shumta, por më i rëndësishmi është varfëria ekstreme (pamundësia për t'u blerë libra e mjete mësimore, veshje për në shkollë apo për t'i ushqyer në mënyrën e duhur). Migrimi dhe emigrimi janë faktorë të tjerë që ndikojnë në përqindjen e regjistrimit apo të braktisjes së shkollës nga fëmijët e këtij komuniteti, paralelisht me mungesën e praktikave për regjistrimin civil për disa fëmijë të lindur jashtë Shqipërisë.. Shpesh mos frekuentimi i arsimit vjen edhe si pasojë e vetëpërgjashtimit nga këto institucione apo tendencës për braktisje të arsimit. Martesat e hershme, në veçanti tek vajzat e vogla i

detyron ato të braktisin shkollën. Pavarësisht përpjekjeve dhe shtimit këto vitet e fundit të numrit të fëmijëve që frekuentojnë kopshtet, problem përbëjnë edhe kapacitetet jo të mjaftueshme për përballimin e nevojave të këtij komuniteti.



4.2.2. Punësimin dhe mirëqenia

Ndonëse shkalla e papunësisë për këtë komunitet është mjaft e lartë, statistikat reale mungojnë. Mungesa e mundësive dhe hapësirave për punësim për anëtarët e komunitetit rom, edhe kur ata kanë një profesion të caktuar është e ndjeshme. Ata angazhohen kryesisht në tregun informal të punës në mbledhjen e materialeve të riciklueshme, tregtinë e rrobave të përdorura dhe punët e rastit. Shumica e tyre nuk kanë kontrata pune e nuk paguajnë sigurime shoqërore. Problemet e papunësisë ndikojnë në mosgarantimin e kushteve normale të jetesës dhe çojnë në probleme të rënda sociale e dhunë në familje. Kushtet e rënda ekonomike në familje, kequshqyerja, mungesa e higjienës dhe e veshmbathjes, shoqërohen edhe raste të braktisjes të fëmijës nga një prind. Shumica e familjeve nuk përfitojnë nga skemat e ndihmave (sipas informacioneve nga Bashkia Roskovec vetëm 4 familje trajtohen me ndihmë ekonomike), pasi nuk janë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile, si dhe për shkak të lëvizjes së vazhdueshme nga një vend në tjetrin.

4.2.3. Strehimi dhe infrastruktura

Strehimi dhe infrastruktura është një nga problemet më të ndjeshme pas mungesës së ushqimit për këtë komunitet, pasi shumë familjeve iu mungon strehimi i sigurtë, kushtet sanitare ose furnizimi me ujë të pijshëm. Në Bashkinë Roskovec do të gjejnë zgjidhje 40 familje të regjistruara si të pastreha. Por kuptohet që nevojat e këtij komuniteti janë shumë më të mëdha. Ata strehohen në shtëpi të mbipopulluara, ku mungojnë pajisjet elementare, kanalizimet dhe uji i pijshëm. Në zonat ku janë përqëndruar romët, familjet jetojnë në ndërtesa të braktisura që më parë kanë qenë pronë e shtetit. Ekzistojnë probleme me infrastrukturën në lagjet ku ata janë të vendosur, të tilla si furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimet, vendbanimet pranë ujrrave të zeza, etj.

4.2.4. Shëndetësia

Si në të gjithë vendin, shërbimi shëndetësor është i pamjaftueshëm, paralelisht me mungesën e kulturës shëndetësore. Kanë përgjithësisht akses në institucionet e shërbimit shëndetësor dhe nuk mund të paguajnë për shërbimet shëndetësore apo ilaçet. Ndihet nevoja për rritje të ndërgjegjësimit për nevojën e higjienës në familje. Pavarësisht punës që është bërë nga Drejtoria e Shëndetit Publik, ka nevojë për vijimësinë e ndërgjegjësimit për çështje që lidhen me shëndetin dhe higjienën.

4.3. MUNDËSITË PËR NDËRHYRJE

Pjesëmarrësit në takime vlerësuan riorganizimin e territorit si një nga mundësitë e mëdha për mire integrimin e këtij komuniteti. Kjo duhet të funksionojë nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm e të gjitha hallkave të pushtetit vendor dhe atij qendror. Me shumë interes u pa edhe ndërveprimi dhe bashkëpunimi i bashkisë me bizneset lokale, jo vetëm në krijimin e klimës së favorshme për të bërë biznes, por edhe si mundësi punësimi për këtë komunitet. Mundësi për këtë komunitet përbën aktivizimi në punët artizanale përmes ngritjes së një punishtetje artizanale apo panairove lokale që ofrojnë mundësi shitjeje. Me interes shihen edhe aktivitetet kulturore e artistike për rivitalizimin e vlerave dhe traditës së tyre kulturore.

Informimi në lidhje me funksionet e reja të njësive vendore dhe konsultimi në procesin e hartimit të buxhetit dhe prioritetëve lokale është shumë i nevojshëm për këtë komunitet. Ndërkohë që me shumë vlerë konsiderohet edhe bashkëpunimi i këtij komuniteti për adresimin e çështjeve të përbashkëta, si dhe me organizatat donatore që punojnë për mbrojtjen e interesave të tyre.

4.3.1 Prioritetet

- Vazhdimi i ndërgjegjësimit për rëndësinë e arsimit;
- Organizimi dhe përfshirja në aktivitet social-kulturore;
- Informim dhe trajnime në fushat e shëndetësisë, edukimit, etj;
- Rritja e aftësisë profesionale përmes kurseve;
- Vijimi i mbështetjes për familjet e pastreha;
- Ofrimi falas i mjeteve didaktike në të gjitha kopshtet për fëmijët e komunitetit rom të nevojshme për frekuentimin e kopshtit.
- Ofrimi i transportit falas për fëmijët rom.
- Përfaqësimi i tyre në organet përfaqësuese

4.4. REKOMANDIME

- **Përgatitja e strategjisë/planit lokal të veprimit për integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian.** Është e rëndësishme të kihet një qasje e integruar dhe strategjike në lidhje me situatën e këtij komuniteti dhe sfidave që vijnë prej saj. Përfshirja dhe mosintegrimi i komunitetit rom ndodh në një sërë fushash, që përfshijnë strehimin, punësimin, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien dhe sigurinë dhe lidhen me faktorë kompleks, të tillë si racizmi e diskriminimi (edhe i fshehtë e jo i drejtpërdrejtë), disavantazhimi, varësia e detyrueshme dhe efektet psikologjike të përvojave të tilla. Ky është një realitet kompleks, i cili kërkon edhe zgjidhje komplekse. Si e tillë, kjo kërkon strategji të integruara dhe afatgjata jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në atë lokal për të adresuar problemet e këtij komuniteti. Qasjet apo përqëndrimi vetëm në një aspekt të veçantë (psh. arsimi), mund të kenë ndikim të rëndësishëm në terma afat shkurtër, por nuk ofrojnë

qendrueshmëri. Për të gjitha këto arsye, është i rëndësishëm hartimi i programeve afatgjata që përfshijnë dhe trajtojnë dhe adresojnë specifikisht secilin komponent. Prandaj një rekomandim i rëndësishëm është përgatitja e strategjisë dhe/ose planit lokal të veprimit për integrimin e komunitetit rom e realizuar me pjesëmarrjen e domosdoshme të këtij komuniteti në proces, e mirëkoordinuar me strategjinë lokale të zhvillimit dhe në harmoni me strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020. Gjithashtu, gjetjet dhe rekomandimet që do të dalin nga plani lokal i veprimit për këtë komunitet duhet të përfshihen në Strategjinë e Zhvillimit Territorial të Bashkisë Roskovec që do të hartohet së shpejti si pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit.

- **Ndërtimi dhe institucionalizimi i partneritetit mes autoriteteve publike dhe këtij komuniteti**
- Partneritetet formale sigurojnë një kuadër të strukturuar për ndërtimin e marrdhënieve të qendrueshme e të suksesshme dhe kërkojnë angazhimin e palëve për të punuar së bashku për arritjen e qëllimit të përbashkët. Në kuadër të partneritetit për të nxitur integrimin e romëve në nivelin lokal, anëtarësia duhet të përbëhet kryesisht nga institucionet publike që janë përgjegjëse për funksionet e ndryshme lokale që ndikojnë në cilësinë e jetës dhe mundësitë e romëve, së bashku me shoqata të shoqërisë civile që punojnë me çështjet që lidhen me këtë komunitet.

Rekomandimi është ngritja e një tryeze të institucionalizuar multidisciplinare me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë lokalë, që përfshin: përfaqësues të Bashkisë (shërbime sociale, strehim, Zyra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve), Qark, Prefekturë, Drejtoria Rajonale e Arsimit, Drejtoria Rajonale e Shëndetit, Zyra Rajonale e Punësimit, Policia, OJQ që merren me çështjen romë dhe përfaqësues të komunitetit rom. Tryeza duhet të përcaktojë frekuencën dhe kalendarin e takimeve dhe duhet të bashkërendojë në vijimësi çështjet e përbashkëta për t'u zgjidhur.

Tashmë me kalimin e funksionit të administrimit dhe rregullimit të sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe tek bashkia, ndërveprimi Bashki - Drejtori Arsimore - Drejtori e Shëndetit Publik është domosdoshmëri për evidentimin e fëmijëve të paregjistruar, të pavaksinuar dhe që nuk frekuentojnë kopshtet/shkollat dhe marrjen e masave të duhura për këto raste. Është i rëndësishëm gjithashtu bashkëpunimi mes Bashkisë, Drejtorisë së Punësimit dhe Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional jo vetëm për identifikimin e punëkërkuësve nga ky komunitet, por edhe për informimin dhe ofrimin e kurseve të kualifikimit profesional për të interesuarit. Shanset e barabarta rritin ndjeshëm edhe mundësitë për integrim, punësim, arsimim dhe mirëqenie sociale.

- **Krijimi i mundësive për strehim social për komunitetin rom dhe egjiptian** - nga Bashkia në bashkëpunim me Ministrinë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrinë së Zhvillimit Urban, paralelisht me modifikimin e aseteve vendore (godinave apo ambienteve pronë e bashkisë) për strehim (të përkohshëm) ose për zhvillim biznesi. Në lidhje me pikën e parë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe e Turizmit çdo vit akordon fonde për përmirësimin e kushteve të jetesës/strehimit të njerëzve në nevojë, përfshirë komunitetin rom dhe egjiptian. Stafi i bashkisë duhet të hartojë projekte që t'i adresohen ministrisë përkatëse dhe të jenë në një linjë me strategjitë rajonale dhe kombëtare. Në Strategjinë e Strehimit Social 2016-2025 flitet gjithashtu për bashkërendim mes Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, organizatave të shoqërisë civile, dhe njësive vendore për procedurat e shpërndarjes së banesave sociale tek përfituesit. Por roli thelbësor kanë njësitë e qeverisjes vendore. Sipas Strategjisë së Decentralizimit, NJQV-të janë përgjegjëse për sigurimin e strehimit dhe për më tepër ajo përcakton se bashkitë do të hartojnë

plane 10-vjeçare të strehimit social, si dhe do të planifikojnë fonde për strehimin social. Bashkitë kanë tashmë në inventarin e tyre prona (asete) të cilat mund të përshtaten dhe të vihen në përdorim (pa qera) për këtë komunitet në nevojë. Siç theksuam më sipër, siguri i kushteve minimale të jetesës do të çonte në lehtësim të aspekteve të tjera dhe pse jo edhe në rritjen e frekuentimit të kopshtit nga fëmijët rom.

- **Krijimi dhe lehtësimi i mundësive për punësim të këtij komuniteti:** Punësimi i familjarëve të komunitetit rom dhe egjiptian që kanë shumë fëmijë dhe i dërgojnë në kopshte në ndërmarrjen e pastrimit të qytetit, mirëmbajtjen e lulishteve, pastrim të institucioneve në varësi të bashkisë, etj. Bashkëpunim me bizneset lokale për gjetjen e mundësive dhe sistemimin në punë të individëve të këtij komuniteti siç e parashikon ligji dhe jo vetëm.
- **Përmirësimi i infrastrukturës** dhe krijimi i hapësirave në zonat ku ata banojnë (rruga e Kurjanit). Rehabilitimi në infrastrukturë duhet të bëhet paralelisht me punën për sistemimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimet (higjienizimi i tyre). Meqenëse Reforma e Territorit sjell vështirësi për ofrim shërbimesh publike me kosto të ulët në njësitë administrative dhe përmirësimi i këtij habitati nuk kërkon punë të kualifikuar, bashkia mund të punësojë individë të këtij komuniteti për rregullimin dhe mirëmbajtjen këtyre ambjenteve.
- Duke qenë që bashkia ka edhe rolin e avokatit të qytetarëve të vetë, **bashkërendimi me Drejtorinë Arsimore Rajonale** mund të konsistojë edhe në evidentimin e fëmijëve rom që shkojnë në shkollë (të identifikuar edhe nga njësitë administrative) dhe ofrimi i listave kësaj të fundit, për pajisjen e këtyre fëmijëve me libra falas sipas udhëzimeve të përbashkëta të ministrive të linjës (cituar më sipër në dokument).
- Data 8 prill, **Dita Ndërkombëtare e Romëve të futet në kalendarin e aktiviteteve të bashkisë** për prezantimin dhe promovimin e traditave dhe kulturës rome, me synim ndërveprimin social-kulturor me pjesën tjetër të komunitetit dhe thyrjen e barrierave diskriminuese. Panairë lokale mund të organizohen me këtë rast, në mënyrë që romët të mund të prezantojnë dhe shesin produktet e tyre artizanale, gjë që do të siguronte edhe të ardhura për familjet e tyre. Gjithashtu, organizimi i aktiviteteve artistike është një mundësi e mirë që romët të mund të përshfaqin muzikën dhe talentet e tyre. Organizimi i një dite të tillë nga bashkia do të shtonte mundësitë për integrim dhe fuqizim të këtij komuniteti.
- **Hartëzimi i nevojave të komunitetit rom** në Bashkinë Roskovec. Ky hartëzim është shumë i rëndësishëm dhe i shërben bashkisë që me anë të mbledhjes së disa treguesve kryesorë të evidentojë dhe planifikojë nevojat më emergjente për komunitetin rom. Bashkia duhet të evidentojë numrin total të popullsisë rome që banon në territorin e saj. Një numër i saktë i familjeve rome, do t'i shërbeje bashkisë për të planifikuar politika sociale. Numri i familjeve rome të regjistruar në njësinë përkatëse nxjerr në pah numrin e personave që përfitojnë nga shërbimet që ofrojnë institucionet vendore.
Numri i fëmijëve romë 0-3 vjeç identifikon fëmijët të cilët mund të regjistrohen në çerdhe. Numri i fëmijëve romë 3-6 vjeç do të ndihmojë DAR dhe Bashkinë për evidentimin e fëmijëve me qëllim regjistrimin e tyre në kopsht dhe klasa përgatitore. Numri i fëmijëve romë 6-15 vjeç evidenton numrin e atyre që janë frekuentues ose që duhet të regjistrohen në arsimin e detyruar 9-vjeçar. Numri i të rinjve romë mbi 18 vjeç shërben për të hartuar politika punësimi për të rinjtë romë të cilët janë një kontigjent pune për të ardhmen.

Bashkia	Total i Popullsisë	Numri i familjeve Rome	Numri familjeve Rome residente	Numri i familjeve Rome që trajtohen me ndihmë ekonomike	Numri i fëmijëve Rom të përgjistruar në gjendjen civile	Numri i fëmijëve Rom 0-3 vjeç	Numri i fëmijëve Rom 3-6 vjeç	Numri i fëmijëve Rom 6-15 vjeç	Numri i të rinjve Rom mbi 18 vjeç
Bashkia Roskovec									

Ne konkluzion,

Ne mendojmë që miratimi i këtij dokumenti nga këshilli bashkiak Roskovec, do sigurojë të një bazë logjike të analizuar mjaftueshëm që këto prioritete dhe rekomandime të bëhen pjesë e strategjisë së zhvillimit të territorit të Bashkisë Roskovec në kapitullin e përmirësimit të shërbimeve sociale. Futja e këtyre prioriteteve dhe rekomandimeve në strategji do të bëjë të mundur aksesimin e fondeve nga donatorë të ndryshëm dhe Qeveria Shqiptare në kuadër të nismave rajonale apo lokale.

ANEKS

BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Veprimtaria e institucioneve të arsimit parauniversitar që realizohet në zbatim të ligjeve, vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave e udhëzimeve në fuqi, të nxjerra nga ministri i Arsimit dhe Sportit, si më poshtë:

- VENDIM Nr. 633, datë 18.9.2003 “Për Miratimin e Strategjisë për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom”
- Ligji Nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për Programet sociale për strehimin e banoreve të zonave urbane” I përditësuar me: Ligjin Nr. 9719, datë 23.04.2007
- VKM Nr. 80, datë 28.01.2008, “Për Miratimin e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”. I përditësuar me: VKM Nr. 1104, datë 30.07.2008
- Udhëzim i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Nr. 647, datë 20.3.2006, mbi “Zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 632, datë 18.09.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkueseve të papuna femra”.
I përditësuar me:
 - Udhëzimin Nr. 647/1, datë 15.05.2006
 - Udhëzimin Nr. 305, datë 07.02.2008
- Ligji Nr. 54/2012 datë 10.5.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar
- Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Dispozitat Normative për sistemin arsimor parauniversitar, 2013, të ndryshuara me Urdhrin Nr. 169, datë 08.05.2014 “Për disa ndryshime në Dispozitat Normative në sistemin arsimor parauniversitar” (vlerësimi i nxënësve në arsimin profesional).
- Kodi i Etikës së Mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit më 30 nëntor 2013.
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 212, datë 16.03.2011 “Për disa shtesa dhe një ndryshim në Vendimin Nr. 107, datë 10.02.2010 të Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar””, si dhe vendimi përkatës për subvencionimin e kategorive të veçanta.

- Udhëzimi i përbashkët i MAS-it dhe MF-së Nr. 51, datë 20.09.2013 “Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”.
- Urdhri Nr. 344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e Njesisë së Shërbimit Psiko-social”.
- Urdhri Nr. 477, datë 06.12.2014 “Për miratimin e kartës së performancës së shkollës dhe Udhëzuesit përkatës”.
- Udhëzimi Nr. 2, datë 05.02.2014 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.
- Udhëzimi Nr. 5, datë 25.02.2013 “Për standardet e përgjithshme të mësuesit”.
- Udhëzimi Nr. 38, datë 07.10.2014 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.
- Udhëzimi Nr. 21, datë 08.08.2014 “Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë”.
- Udhëzimi Nr. 12, datë 27.04.2015 “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe për përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”.
- Udhëzimi Nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 44, datë 15.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH Nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar””.
- Udhëzimi Nr. 15, datë 12.07.2013 “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”.
- Udhëzimi Nr. 23, datë 02.08.2013 “Për ndjekjen e gjimnazit me kohë të pjesshme”.
- Udhëzimi Nr. 24, datë 02.08.2013 “Për certifikimin e hartuesve të testeve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare”.
- Udhëzimi Nr. 25, datë 02.08.2013 “Për organizmin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve”.
- Udhëzimi Nr. 26, datë 02.08.2013 “Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të këshillit të mësuesve”.
- Udhëzimi Nr. 27, datë 02.08.2013 “Për bordin e institucionit arsimor”.
- Udhëzimi Nr. 28, datë 02.08.2013 “Për pajisjen e nxënësve me dëftesë klase”.
- Udhëzimi Nr. 29, datë 02.08.2013 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme”.
- Udhëzimi Nr. 30, datë 02.08.2013 “Për rregulloren tip të institucioneve arsimore”.

- Udhëzimi Nr. 31, datë 02.08.2013 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë”.
- Udhëzimi Nr. 34, datë 02.08.2013 “Për planifikimin e fondeve buxhetore dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit për blerjen e librave të institucioneve arsimore publike”.
- Udhëzimi Nr. 36, datë 13.08.2013 “Për procedurat për arsimimin e fëmijëve të ngujuar”.
- Udhëzimi Nr. 38, datë 13.08.2013 “Për arsimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e përkujdesjes shoqërore”.
- Udhëzimi nr. 43, 21.08.2013 “Për planifikimin e fondeve buxhetore, prokurimin dhe blerjen e mjeteve mësimore për institucionet arsimore publike”.
- Udhëzimi Nr. 44, datë 21.08.2013 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”.
- Udhëzimi Nr. 56, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin arsimor publik”.
- Udhëzimi Nr. 35, datë 30.09.2014 “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar”.
- Udhëzimi nr. 57, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit arsimor publik”.
- Udhëzimi Nr. 58, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit arsimor publik”.
- Udhëzimi Nr. 42, datë 15.10.2014 “Për arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e paraburgimit, të vuajtjes së dënimit”.
- Udhëzimi Nr. 14, datë 12.5.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar”.
- Rregullorja Nr. 336, datë 14.07.2011 “Për organizmin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”.
- Standardet e drejtorit (hartuar nga IZhA, miratuar me shkresën nr. 4296 prot., datë 27.08.2013).
- Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare , nr. 1794, datë 13.03.2013 dhe udhëzuesi për Shkollat Qendra Komunitare, tetor 2014.
- Vendim i KM Nr. 574, datë 29.8.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore.
- VKM Nr. 526, datë 06.08.2014, Për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara që trajtohen me përparësi si përfitues të programeve sociale të strehimit

- Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 11, datë 9.3.2015 Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 89, datë 26.1.2012 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurave të shërbimit të kujdestarisë”. (Nr. 45)
- Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 22, datë 20.8.2015 Mbi zbatimin e vendimit Nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar. (Nr. 156)
- Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 23, datë 20.8.2015 Mbi zbatimin e vendimit Nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar. (Nr. 156)
- Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 24, datë 20.8.2015 Mbi zbatimin e vendimit Nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar. (Nr. 156)
- Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Nr. 7, datë 25.2.2015 Për një ndryshim në udhëzimin Nr. 3, datë 10.3.2014 “Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar”. (Nr. 36)

